

RAPORTI VJETOR I INSTAT

2023

Tabela e Përmbajtjes

Përmbajtja

Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT	3
Lista e Shkurtimeve.....	5
I. Sistemi Kombëtar Statistikor.....	6
Parimet e statistikave zyrtare	6
Zbatimi i objektivave strategjikë 2022-2026 të Sistemit Kombëtar Statistikor	8
II. Zbatimi i PSZ për vitin 2023	10
Fusha “Statistikat Demografike dhe Sociale”	10
Fusha “Statistikat Ekonomike”	11
Fusha “Statistikat Sektoriale”	11
Fusha “Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain”	12
III. Censet.....	12
Censi i Popullsisë dhe Banesave	12
Censi i Bujqësisë	14
IV. Veprimtaria e Institutit të Statistikave – INSTAT	15
Historiku, vizioni, misioni, vlerat	15
Integrimi Evropian	17
Koordinimi i Projekteve	21
V. Menaxhimi i Cilësisë.....	24
Ngarkesa e të Intervistuarve	25
VI. Teknologjia e Informacionit	31
VII. Komunikimi dhe Publikimet	32
VIII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)	40
IX. Organigrama dhe baza ligjore	40
X. Veprimtaria e organizmave mbështetës të prodhimit statistikor	45
Veprimtaria e Bordit Drejtues	45
Veprimtaria e Këshillit të Statistikave	46
Veprimtaria e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave	47
XI. Zbatimi i Rekomandimeve	47
Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit	47

Zbatimi i Rekomandimeve të Peer Review 2018	52
XII. Burimet financiare dhe njerëzore	54
Burimet Financiare	54
Burimet Njerëzore	58
Aneksi nr. 1. Të dhënat kryesore	61
Aneksi Nr.3 Fushata e komunikimit në kuadër të Censit të Popullsisë dhe banesave 2023.....	61
Aneksi nr. 4 Memorandumet e Mirëkuptimit	66
Aneksi nr. 5 Lista e Nomenklaturave në fuqi	67

Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT

Të nderuar,

Viti që sapo kaloi për Institutin e Statistikave dhe agjencitë e tjera statistikore ka qenë një vit me angazhime dhe sfida të mëdha. Përpara jush kam kënaqësinë të paraqes në rolin e koordinatorit veprimtarinë performuese dhe statistikore për vitin 2023, të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe Institutit të Statistikave, si një institucion i pavarur, profesional, në respektim të Kushtetutës së Shqipërisë, Parimeve Themelore të Statistikave Zyrtare dhe Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane!

Viti 2023 angazhoi INSTAT dhe Sistemin Kombëtar Statistikor në realizimin e aktiviteteve statistikore dhe objektivave strategjikë 2022-2026, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”. Pa anashkaluar rëndësinë e aktiviteteve të tjera statistikore të cilat zhvillohen çdo vit, dëshiroj të ndalem në sfidën më të madhe profesionale që shoqëroi INSTAT-in gjatë këtij viti, në atë të realizimit me sukses të Censit të Popullsisë dhe Banesave. Censi fillimisht ishte planifikuar të kryhej në fillim të kësaj dekade, viti 2020, por u shty për një sërë faktorësh, ku ndër më kryesoret ishte pandemia globale – Covid 2019. Në nivel global, në 60 vende të botës u shty realizimi i censit i planifikuar në vitet 2020-2021, dhe 137 vende përshtatën zbatimin e censit nga versioni fillestar. Impakti i Covid-19 është analizuar në mjaft takime në nivel botëror, evropian dhe kombëtar, duke sjellë nevojën për përshtatjen dhe përditësimin e pyetësorit dhe rishikimin e qasjeve inovative në skicimin e veprimtarive përgatitore. Në këtë mënyrë, institucionet statistikore, përfshirë edhe INSTAT-in, u përgatitën edhe për menaxhimin e situatave të tjera të mundshme në kohë krize në aspektin e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave.

Metodologjia e censit përkon me zbatimin e rekomandimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nga Komisioni Ekonomik për Evropën (UNECE) për raundin e censeve 2020 dhe Rregullores së Bashkimit Evropian. Pyetësori i Censit u hartua në bashkëpunim me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe në diskutim edhe me grupet e interesit në vend. Në përmbajtje të tij ishin 8 module, të cilat lidhen me informacione mbi ndërtesën, banesën, familjen, individin, bujqësinë, të larguarit, vizitorët, banesat kolektive dhe të pastrehët.

Censi u realizua në periudhën 18 Shtator – 30 Tetor 2023. Si pasojë e ndërtimeve të reja pas vitit 2020, kryesisht edhe për shkak të rindërtimeve nga tërmetet, në 3 përqind të zonave Censi zgjati deri më 15 Nëntor 2023. Anketa për matjen e cilësisë dhe mbulimit të Censit u realizua në periudhën 20 Nëntor – 20 Dhjetor 2023. Në Cens u angazhuan rreth 7500 të punësuar në procesin e grumbullimit të informacionit dhe 200 persona të punësuar të këtij institucioni, si trajnerë dhe monitorues të terrenit.

Për të patur një rezultat të vetëm të informacionit mbi popullsinë rezidente dhe të banesave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në konsultim me asistencën teknike të siguruar me mbështetjen e Bashkimit Evropian, INSTAT-i përcaktoi planin e publikimit të rezultateve kryesore në Qershor të vitit 2024, dhe rezultateve të detajuara në Tetor të vitit 2024. Kjo periudhë do të jetë sfiduese për një institucion statistikor, i cili synon të sigurojë profesionalizëm, cilësi dhe transparencë në publikimin e rezultateve të Censit. Përdoruesve do t'i vihet në dispozicion një e mirë publike, një informacion i rëndësishëm dhe mjaft i domosdoshëm për të ndihmuar proceset zhvillimore dhe vendimmarrëse.

Në bashkërendim me agjencitë statistikore, INSTAT-i ka realizuar dhe 104 aktivitete të tjera statistikore, duke ofruar 171 publikime, sipas Planit Vjetor 2023, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Ndërkohë, janë ndjekur me përparësi aktivitetet në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe përafrimit, zbatimit të

strategjisë kombëtare për zhvillim, të strategjive sektoriale apo kërkesave ndërkombëtare, duke mbyllur një vit statistikor me tregues pozitiv.

Pavarësisht sfidave, INSTAT-i, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, kanë punuar me profesionalizëm për përmbushjen e aktiviteteve, duke pasqyruar një frymë bashkëpunimi dhe bashkërendimi të veprimtarive, në drejtim të zbatimit të parimeve themelore të statistikave. Kjo është reflektuar më së miri në rritjen e indekseve të besueshmërisë së publikut në statistika dhe cilësisë së tyre. Nga të dhënat e anketës së kënaqësisë së përdoruesve rezulton se cilësia statistikore është vlerësuar me 4.18 pikë, ndërsa besueshmëria në statistika 4.04 pikë nga niveli maksimal prej 5 pikësh. Këta tregues nxisin punonjësit e INSTAT-it dhe Sistemit Kombëtar në tërësi për të dhënë më shumë kontribut për një performancë institucionale pozitive në drejtim të furnizimit me produkt të bollshëm dhe cilësor. Përsa i përket treguesit mbi numrin e klikimeve për temat kryesore statistikore, krahasuar me një vit më parë, ky tregues pësoi një rritje prej 406,660 klikime ose 23.4%.

Cilësia e treguesve, afati kohor, gama e gjerë, granulariteti, aksesimi në të dhëna mikro, ruajtja e konfidencialitetit, zbatimi i standardeve në kryerjen e proceseve, i kanë bërë këto statistika të krahasueshme me vendet evropiane dhe në nivel global. Gjithashtu, kanë bërë që agjencitë statistikore të rrisin numrin e treguesve në databazën evropiane apo databazat e institucioneve ndërkombëtare, të aksesueshme nga çdo përdorues.

Marrëveshjet me institucionet në vend, me botën akademike, shoqëritë civile, apo dhe marrëveshjet me institucionet simotra, kanë rritur frymën e bashkëpunimit dhe koordinimit, në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve, shkëmbimit të informacionit, metodave apo standardeve bashkëkohore, shpërndarjes së dijeve, në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së edukimit statistikor.

Këshilli i Statistikave, si zëri kryesor i përdoruesve të ndryshëm, ka dhënë kontribut domethënës në monitorimin e performancës statistikore në drejtim të zbatimit të parimeve dhe standardeve për proceset statistikore dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. Anëtarët e Këshillit kanë luajtur rol aktiv në dhënien periodikisht të opinioneve dhe sugjerimeve në dokumentet planifikuese dhe raportet e ecursisë së zbatimit të tyre.

INSTAT dhe agjencitë statistikore, kontribuan në hartimin e raportit të konkurueshmërisë me vendet e rajonit të ballkanit, ku performanca pozitive e klasifikoi këtë vend në krye të listës së këtyre vendeve, për nga sasia dhe cilësia e informacionit të ofruar.

Sfida në vijim e këtij institucioni, në bashkëpunim me institucionet e fushës, është realizimi me sukses i Censit të Bujqësisë, forcimi i rolit si koordinator kombëtar në zbatimin e parimeve themelore të statistikave, zbatimi i metodave inovative dhe bashkëkohore në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, duke i konsideruar ato një të mirë publike në drejtim të prioritetëve kombëtare për zhvillim dhe integrim dhe arritjes së objektivave për zhvillim të qëndrueshëm. .

Sinqerisht,

Dr. Elsa DHULI

Drejtor i Përgjithshëm

Lista e Shkurtimeve

CAPI	Intervistë me Kompjuter (<i>Computer Assisted Personal Interview</i>)
CATI	Intervistë me telefon (<i>Computer-Assisted Telephone Interviewing</i>)
CAWI	Intervistë me link (<i>Computer Assisted Web Interview</i>)
ESA	Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (<i>European system of national and regional accounts</i>)
ESSPROS	Sistemi i Integruar Evropian për Mbrojtjen Sociale (<i>European system of integrated social protection statistics</i>)
GFSM	Manuali për Statistikat Financiare të Qeverisë (<i>Government Finance Statistics Manual</i>)
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik (<i>Geographic Information System</i>)
GNPIE	Grupet Ndërinstitucionale për Integrimin Evropian
GSBPM	Modeli për Planifikimin e Fazave të Prodhimit Statistikor (<i>Generic Statistical Business Process Model</i>)
ICCS	Klasifikimi Ndërkombëtar i Krimeve për Qëllime Statistikore (<i>International Classification of Crime for Statistical Purposes</i>)
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ISTI	Sistemi i Integruar i Prodhimit Statistikor (<i>Integrated System Technology</i>)
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PPB	Produkti i Brendshëm Bruto
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PRODCOM	Klasifikimi Statistikor sipas Produkteve Industriale (<i>Production Communautaire</i>)
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SALSTAT	Projekti për Statistika të Forta Vendore Shqiptare
SIMONA	Sistemi për aksesimin nga jashtë të të dhënave mikro
SKS	Sistemi Kombëtar Statistikor
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë

I. Sistemi Kombëtar Statistikor

Sistemi Kombëtar Statistikor në Shqipëri përbëhet nga tërësia e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare sipas Programit të Statistikave Zyrtare. Përkufizimi, veprimtaria dhe aktivitetet koordinuese janë të parashikuara në legjislacionin për statistikën zyrtare.

Aktualisht, prodhuesit e statistikave zyrtare janë:

- a) Instituti i Statistikave dhe zyrat statistikore rajonale në varësi të tij;
- b) Banka e Shqipërisë;
- c) Ministria e Financave;
- ç) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Agjencitë statistikore zhvillojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë statistika zyrtare, të cilat lidhen me fushën e kompetencave të parashikuara në legjislacionin për organizimin e funksionimin e tyre, si dhe në përputhje me parimet e statistikave zyrtare, të përcaktuara në legjislacionin për statistikën zyrtare.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikën zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore udhëhiqen nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane. Këto parime përcaktojnë standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane, për të siguruar statistika cilësore dhe për të arritur besueshmërinë e përdoruesve në to. Parimet e statistikave zyrtare që përmban ky kod janë të përafëruara edhe në ligjin për statistikën zyrtare, përkatësisht në nenet 4 e 5 të tij.

Në vitin 2023 është punuar për të forcuar dhe siguruar qëndrueshmëri në zbatimin e parimeve, ku mund të veçojmë:

- a) **"paanshmëria"**, që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit.

Në drejtim të këtij parimi INSTAT është fokusuar në përcaktimin e burimit të të dhënave administrative që janë përdorur për prodhimin statistikor, duke vendosur edhe standardet përkatëse të metodologjisë së prodhimit. Këto standarde janë reflektuar në raportet e cilësisë, të cilat i janë vënë në dispozicion publikut nëpërmjet faqes elektronike zyrtare.

Nga ana tjetër, prodhuesit e statistikave zyrtare kanë mbajtur kontakte të ngushta me median për njoftimin e publikut mbi datat e publikimit të rezultateve apo zhvillimet e konferencave.

- b) **"besueshmëria"**, që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Parimi i besueshmërisë nënkupton përdorimin e kritereve shkencore për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave.

Në drejtim të besueshmërisë, prodhuesit e statistikave zyrtare janë fokusuar në adaptimin e praktikave më të mira nga ana shkencore për arritjen e produkteve cilësore. Eurostat dhe Kombet e Bashkuara

nxjerrin vazhdimisht udhëzime statistikore të këtij aspekti. Për vitin 2023 mund të veçohen udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna për kryerjen e censit të radhës të popullsisë dhe banesave.

- c) **"pavarësia profesionale"**, që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, të cilit nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloj grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor.

Pavarësia profesionale e prodhuesve statistikorë zyrtarë është e garantuar me ligj. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM nr. 650, datë 10.11.2017 "Për angazhimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ruajtjen e besimit në statistika" ka konfirmuar garantimin dhe mbrojtjen e pavarësisë profesionale të INSTAT-it nëpërmjet mbështetjes në ruajtjen e besimit të publikut në statistikat zyrtare. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave garanton sigurimin e burimeve të përshtatshme për kryerjen e aktiviteteve dhe përmirësimin e cilësisë statistikore.

- ç) **"kosto-efektiviteti"**, që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar.

Për të siguruar kosto-efektivitetin, INSTAT operon institucionalisht me strukturat e ngritura në drejtim të respektimit të kuadrit ligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Planifikimi i hershëm i aktiviteteve ka ndikuar në vlerësimin në kohë reale të efektshmërisë së parashikuar, duke përdorur sa më pak burime financiare dhe duke shmangur aktivitetet e dubluara.

- dh) **"konfidencialiteti statistikor"**, që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jo-statistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm.

Për të siguruar konfidencialitetin statistikor dhe mbrojtur të dhënat personale, INSTAT ka miratuar udhëzime dhe rregullore për t'u respektuar rigorozisht nga personeli i përfshirë. Të dhënat e mbledhura trajtohen sipas metodës "one way" dhe nuk i jepet akses asnjë strukture apo institucioni tjetër, pavarësisht statusit juridik të tij. Së fundmi, INSTAT po punon ngushtësisht me AKCESK-un për të forcuar më tej sigurinë ndaj sulmeve kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial.

- d) **"transparenca"**, që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Në interes të transparencës, INSTAT jo vetëm ka vënë në dispozicion të publikut çdo informacion mbi metodat e përdorura për prodhim statistikor, por edhe ka publikuar çdo angazhim të ndërmarrë në aspektet e vendimmarrjes dhe llogaridhënies. Kështu, në faqen zyrtare janë bërë publike dokumentacionet e mbledhjeve që ka zhvilluar Këshilli i Statistikave, Bordi Drejtues dhe organizmat e tjerë. Faqja zyrtare e INSTAT-it përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për të interesuarit mbi procedurat që duhet të ndjekin për marrjen e të drejtës së hyrjes në të dhëna, formatet që duhet të përdorin etj. Programi i transparencës respektohet sipas kërkesave të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit.

Zbatimi i objektivave strategjike 2022-2026 të Sistemit Kombëtar Statistikor

Objektivat strategjikë për zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor janë të parashikuar në Ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”. Çdo objektiv është shoqëruar me masa zbatuese konkrete, si dhe me treguesit përkatës për matjen e performancës dhe raportimin e ecurisë së tyre.

Gjatë vitit 2023 janë shënuar arritje në drejtim të përmbushjes të objektivave strategjike zhvillimore të SKS-së. Siç vihet re në tabelën e mëposhtme, vlerat e pjesës më të madhe të indikatorëve të performancës kanë pësuar rritje krahasuar me një vit më parë.

Tabela 1: Indikatorët e performancës 2022-2023

Indikatorët e Performancës	2022	2023	Trendi
Infrastruktura			
Nr. i agjencive Statistike	3	3	→
Nr. i Memorandumeve/Marrëveshjeve të bashkëpunimit	35	39	↑
Nr. i trajnimeve	11	14	↑
Prodhimi			
Nr. i burimeve administrative të përdorura	51	51	→
Nr. i data point në databazën e Eurostat për Shqipërinë	4.579.293	5.335.020	↑
Nr. i data point në databazën e INSTAT	3.820.369	4.152.944	↑
Numri i treguesve në nivel bashkie	187	187	→
Nr. i aktiviteteve me përmirësim në afat	3	2	↓
Nr. i aktiviteteve me përmirësim në frekuencë	0	0	→
Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	78	83	↑
Numri i raporteve të cilësisë	52	56	↑
Përdoruesi			
Nr. i takimeve konsultative-informuese me përdoruesit	11	78	↑
Nr. i publikimeve	165	171	↑
Nr. i botimeve tematike	9	12	↑
Nr. i klikimeve (page views)	3.585.663	3.020.981 ¹	↓
Indeksi i Nivelit të përgjithshëm të kënaqësisë së përdoruesve	3.93	4.02	↑

Gjatë vitit 2023, ecuria e arritjes së objektivave strategjike të SKS është si vijon:

Objekti 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integrimit Evropian. Kapitulli 18 “Statistikat” i *acquis* është konsideruar nga BE si një ndër kapitujt kryesorë të nevojshëm për t’u përafëruar me standardet evropiane. Për këtë arsye, ai bën pjesë në grupin Themeltar (Cluster 1) të akteve komunitare (*acquis*). Në aspektin përafërues, gjatë vitit 2023, **u miratuan në Bordin Drejtues të INSTAT 2 projekt-udhëzime:** -Udhëzimi “Për zbatimin e parimeve për matjen e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare” dhe Udhëzimi “Për zbatimin e parimeve në anketat statistikore të qumështit dhe nën-produkteve të tij”. Përsa i përket vlerës së indikatorëve të performancës për këtë objektiv, vlen të vihet në dukje **rritja prej 17% e numrit të të dhënave (datapoints)** të transmetuara në Eurostat krahasuar me një vit më parë, duke e çuar numrin total të tyre në 5,335,020. Në harkun kohor 5 vjeçar, të dhënat e transmetuara kanë pësuar një rritje prej 238%. Në vitin 2019 ky numër ishte vetëm 1,382,072 *data points*. Përsa i përket zbatimit të rekomandimeve të Eurostatit, duke marrë parasysh natyrën e rekomandimeve të Peer Review dhe kushtet e reja legjislative në të cilat operon

¹ Është ulur numri i përgjithshëm i klikimeve, por numri i klikimeve për temat kryesore statistikore, krahasuar me një vit më parë, ka pësuar një rritje prej 406,660 klikime ose 23.4 %.

SKS, mund të themi se **këto rekomandime janë përmbushur plotësisht**. Tashmë INSTAT është në pritje të raundit të ri të këtij ushtrimi, i cili do të shërbejë për përcaktimin e objektivave zhvillimore në harkun kohor 2027-2031.

Objektivi 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare. Objektivi parashikon rritjen e numrit të statistikave të prodhuara, duke përafruar sa më tepër kërkesat e përdoruesve për të dhëna. Numri i publikimeve për vitin 2023 ishte 171 nga 165 publikime që ishin një vit më parë. **Sipas parashikimeve të Programit të Statistikave Zyrtare, janë prodhuar 1089 tregues statistikorë dhe 66 tregues statistikorë në aspektin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.** Në kuadër të plotësimit të nevojave të jashtme për të dhëna, janë plotësuar 43 pyetësorë statistikorë të kërkuar nga institucione statistikore apo organizata të ndryshme ndërkombëtare. Në harkun njëvjeçar, në faqen e INSTAT-it janë shënuar **3,020,981 klikime**. Për vitin 2023, rezultatet e anketës së kënaqësisë së përdoruesve treguan një rritje të nivelit të kënaqësisë me 1.74 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, duke e çuar këtë vlerë në **shkallën 4.02 pikë** nga 5 pikë të plota.

Objektivi 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare. Në kuadër të këtij objekti, Sistemi Kombëtar Statistikor është angazhuar në adoptimin e klasifikimeve të reja ndërkombëtare që mundësojnë përafrimin, harmonizimin dhe krahasueshmërinë e statistikave të prodhuara në vendin tonë me ato të vendeve të tjera evropiane apo ndërkombëtare. Përveç përafrimit të akteve ligjore të të përmendura në Objektivin 1, është punuar edhe në drejtim të cilësisë statistikore. Përsa i përket menaxhimit të kontrollit të cilësisë së produkteve statistikore, **janë publikuar 56 raporte cilësie** në krahasim me 52 të tilla për vitin 2022. Ky tregues dëshmon përpjekjen për t'i ofruar përdoruesve informacionin e nevojshëm mbi standardet dhe metodat e prodhimit statistikor, si dhe informacion mbi cilësinë e statistikave të prodhuara. Nga viti në vit është rritur numri i aktiviteteve të dokumentuara sipas standardit ndërkombëtar të proceseve statistikore (GSBPM), ku deri në vitin 2023 janë dokumentuar **83 aktivitete** krahasuar me 78 të tilla deri në fund të vitit 2022.

Objektivi 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare. Zgjerimi i Sistemit Kombëtar Statistikor nënkupton shtimin e institucioneve prodhuese dhe furnizuese me të dhëna, rritjen e gamës së produkteve statistikore të prodhuara dhe kapaciteteve profesionale të stafit të angazhuar. Gjatë vitit 2023, ka vijuar bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), ku pas dakordësisë së AKBN për t'u bërë pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, INSTAT përfshiu AKBN në projekt-planin vjetor të PSZ 2024, si institucion përgjegjës për prodhimin dhe publikimin e statistikave të Bilancit Energjitik me frekuencë tremujore dhe Bilancit Energjitik me frekuencë vjetore. Me vendim Kuvendi, nr. 15/2024 "Për miratimin e Planit Vjetor 2024 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026", AKBN bëhet agjencia e katërt statistikore pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor. Përsa i përket nivelit të disagregimit të të dhënave të marra nga burimet administrative, **numri i institucioneve që ofrojnë të dhëna në nivel mikro është 4**, vlerë që përkon me parashikimin e PSZ-së. Numri i regjistrave statistikorë me të dhënat mikro nga institucionet furnizuese është 15, numër i njëjtë me atë të vitit të kaluar. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit të SKS-së dhe përmirësimit të cilësisë së produkteve statistikore, gjatë vitit 2022 INSTAT-i ka zhvilluar **6 trajnime, ku janë trajnuar 295 persona** dhe në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave janë zhvilluar edhe **8 trajnime, ku janë trajnuar 7018 persona**.

Objektivi 5: Modernizimi i mëtejshëm i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare. Modernizimi i vazhdueshëm i metodave të prodhimit statistikor është gjithnjë e më shumë në fokus të Sistemit Kombëtar Statistikor, pasi përbën mekanizimin kryesor për prodhimin e statistikave në përputhje me standardet e kërkuara nga Eurostat dhe teknikat moderne ndërkombëtare. Duke qenë se ndër hallkat kryesore të

procesit të prodhimit statistikor është ajo e grumbullimit të të dhënave, gjithnjë synohet modernizimi i metodave të këtij procesi, si: metodat me telefon, web, laptop, tablet (CATI/CAWI/CAPI). Në këtë aspekt, në vitin 2023: **u ndërtua 1 aplikacion CATI dhe u përditësuan 6 aplikacione CATI**; **u ndërtua 1 aplikacion CAWI**; **u ndërtua 1 aplikacion CAPI dhe u përditësuan 18 aplikacione CAPI**. Modernizimi i teknikave dhe metodave të grumbullimit statistikor ka sjellë dhe ulje të nivelit të ngarkesës së të intervistuarve, si një ndër aktivitetet përmirësuese të ndërmarra në zbatim të rekomandimeve mbi Vlerësimin e Cilësisë (Peer Review) 2018.

Objektivi 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur. Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor përbën një ndër platformat kryesore mbi të cilat SKS ngre dhe mbështet veprimtarinë e tij prodhuese. Matja e besimit në statistika realizohet nëpërmjet anketës së kënaqësisë së përdoruesve, ku një ndër variablat është besueshmëria e përdoruesve në profesionalizimin dhe pavarësinë e sistemit. Nga anketa e kënaqësisë së përdoruesve 2023, treguesi i besueshmërisë së përdoruesve në të dhënat e INSTAT arriti vlerën 4.04 pikë, duke **pësuar një rritje prej 0.1 pikë** krahasuar me një vit më parë, ku kjo vlerë ishte 3.94 pikë nga 5 pikë të plota. Sa i përket referimit ndaj produkteve statistikore në media, për vitin 2023 numri i përmendjeve rezultoi: 2913 herë në përmbajtjen e 1.585 artikujve të botuar në shtypin shqiptar; 42 herë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme; 1231 herë në përmbajtjen e 1082 kronikave në lajmet kryesore të televizioneve më të ndjekura në Shqipëri; 22.569 herë në përmbajtjen e 11.396 artikujve të publikuara në portalet online. Organizimi i takimeve/aktiviteteve me fokus ndërgjegjësimin statistikor dhe shmangien e keqinterpretimit të statistikave është një ndër masat e rëndësishme të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e besueshmërisë. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 INSTAT-i ka zhvilluar **8 aktivitete të tilla** me grupe të ndryshme përdoruesish. Në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave janë zhvilluar rreth 70 takime informuese në të gjithë bashkitë e vendit.

II. Zbatimi i PSZ për vitin 2023

Referuar Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, për vitin 2023 ishte planifikuar realizimi i 104 aktiviteteve statistikore, nga të cilat 93 aktivitete statistikore nga INSTAT-i, 9 nga Banka e Shqipërisë dhe 2 nga Ministria e Financave.

Informacioni në vijim paraqet në mënyrë të përmbledhur arritjet kryesore në drejtim të zbatimit të PSZ sipas fushave statistikore, si dhe aktivitetet statistikore të paplanifikuara në Program, por që kanë kontribuar gjithashtu në realizimin e objektivave të Sistemit Kombëtar Statistikor. (Aktivitetet e detajuara për secilën fushë statistikore paraqiten në Aneksin Nr.1 të këtij dokumenti).

Fusha “Statistikat Demografike dhe Sociale”

Fusha mbi Statistikat Demografike dhe Sociale mbulohet nga INSTAT. Gjatë vitit 2023, janë realizuar 29 aktivitete statistikore nga të cilat janë prodhuar 444 tregues mbi: popullsinë; të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesit; ndarjen me bazë gjinore; punësimin dhe papunësinë; konsumin e njësive ekonomike familjare; nivelin e jetesës; arsimin; shëndetësinë; mbrojtjen sociale; krimet; kulturën. Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj fushe janë kryer anketa mbi: Buxhetin e Familjes, të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës, Forcat e Punës dhe mbi Strukturën e të Ardhurave nga Puna.

- Ndër aktivitetet kryesore të ndjekura me shumë prioritet ishte puna përgatitore dhe realizimi i procesit të mbledhjes së të dhënave për Censin e Popullsisë dhe Banesave. Informacioni i detajuar mbi realizimin e këtij aktiviteti gjendet në vijim të raportit, në seksionin “Censi i Popullsisë dhe Banesave”. Gjithashtu, janë kryer aktivitete mbështetëse statistikore, të cilat kanë kontribuar në arritjen e objektivave në drejtim të

përmirësimit të mëtejshëm të prodhimit statistikor, për zbatimin e strategjive në të cilat INSTAT kontribuon me të dhëna, si dhe në kuadër të integritit evropian. Ndër këto aktivitete mund të veçojmë: përmirësimin e statistikave vitale në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, aktivitet i cili u mbështet nga projekti SALSTAT, ku gjatë vitit 2023 u zhvilluan 6 trajnime për punonjësit e zyrave rajonale të Gjendjes Civile në 6 qarqe. Gjithashtu ka vijuar pilotimi i Anketës së Buxhetit të NjEF në 6 Bashki. Gjatë vitit 2023, INSTAT ka vijuar me ndjekjen e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019-2022, Strategjisë Ndërsektoriale për të Miturit 2021-2025 dhe Strategjisë për Barazinë Gjinore 2021-2030.

Fusha “Statistikat Ekonomike”

Kjo fushë mbulohet nga INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave. Gjatë vitit 2023 janë realizuar 19 aktivitete statistikore, nga të cilat janë prodhuar 241 tregues mbi llogaritë kombëtare me frekuencë vjetore dhe tremujore, statistikat strukturore dhe afatshkurtra të ndërmarrjeve, statistikat monetare dhe financiare, të borxhit etj.

- Si arritje kryesore për vitin 2023 mund të përmendim përmirësimet metodologjike dhe rritjen e nivelit të përputhshmërisë së statistikave ekonomike me kërkesat e *acquis communautaire*, ku fokusi kryesor ka qenë rritja e numrit të treguesve statistikorë dhe zgjerimi i serive kohore të transmetuara në EUROSTAT për treguesit e llogarive kombëtare, statistikat e produkteve industriale (PRODCOM) dhe statistikat afatshkurtra. INSTAT publikoi për herë të parë të dhënat e Anketës së Produkteve Industriale (PRODCOM) sipas Listës së Produkteve Industriale në nivel të detajuar 8-shifror, e cila përdoret në vendet e Bashkimit Evropian. Vrojtimi mbi produktet industriale kryhet me frekuencë vjetore pranë ndërmarrjeve të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese dhe ka si qëllim të ofrojë informacion mbi prodhimin dhe shitjen e produkteve industriale të realizuara nga ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin e tyre ekonomik në vendin tonë. Me mbështetjen e programit IPA 2019 janë zbatuar aktivitetet për përmirësimin e statistikave të llogarive kombëtare, statistikave financiare dhe statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve. Gjatë këtij viti INSTAT ka ndjekur rekomandimet për auditin statistikor të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve.

Fusha “Statistikat Sektoriale”

Kjo fushë mbulohet nga INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. Gjatë vitit 2023 janë realizuar 45 aktivitete statistikore, nga të cilat janë prodhuar 345 tregues mbi: bujqësinë, energjinë, transportin, turizmin, tregtinë e jashtme, çmimet, shkencën, teknologjinë dhe inovacionin.

- Rritja e cilësisë dhe shtimi i treguesve statistikorë lidhur me “Statistikat sektoriale”, ka qenë në fokus të objektivave për vitin 2023, me qëllim për t'i mundësuar politikbërësve të hartojnë strategjitë e duhura për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve në sektorët e kësaj fushe. Zhvillimet kryesore në këtë fushë lidhen me përmirësimet metodologjike dhe rritjen e nivelit të përputhshmërisë së këtyre statistikave me kërkesat e Akteve Komunitare. Gjatë vitit 2023 vazhdoi puna përgatitore për Censin e Bujqësisë. Informacion më i detajuar për këtë aktivitet është dhënë në kapitullin nr. III “Censet”. Lidhur me statistikën e TIK në familje, u testua dhe u vendos në zbatim metoda CATI për mbledhjen e të dhënave. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 janë realizuar edhe aktivitete mbështetëse statistikore që lidhen me: ndjekjen e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023; kontributin në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030; pjesëmarrjen e Shqipërisë në raportin “European Innovation Scoreboard 2023”. Një tjetër aktivitet mbështetës statistikor ka qenë dhe zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të programit IPA 2019 mbi Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, Indeksin e Çmimeve të Banesave dhe Matjen e Fuqisë Blerëse.

Fusha “Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain”

Kjo fushë mbulohet nga INSTAT. Gjatë vitit 2023 janë realizuar 11 aktivitete statistikore, nga të cilat u prodhuan 50 tregues mbi: mbi llogaritë fizike dhe monetare në mjedis, ujin, zhurmat, mbetjet, etj.

- Ndër zhvillimet kryesore në fushën e statistikave të mjedisit, gjatë vitit 2023, ka qenë transmetimi për herë të parë në Eurostat i të dhënave mbi mbetjetet industriale. Gjithashtu, u prodhuan për herë të parë statistikatat mbi taksat mjedisore sipas industrisë dhe u ndërtua sistemi për prodhimin e llogarive të emetimeve në ajër, sistemi për prodhimin e llogarive të flukseve fizike të energjisë dhe sistemi për prodhimin e llogarive në pyje.
- Për temën e informacionit statistikor rajonal dhe gjeohapësinor, gjatë vitit 2023 ka vijuar procesi i përditësimit të vazhdueshëm të njësive statistikore, përditësimi i gjeodatabazës dhe mbështetja gjeografike e Censit të Popullsisë dhe Banesave. Në kuadër të projektit SALSTAT, ka vijuar puna në lidhje me ndërtimin e regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave (ASRBD). Gjatë vitit është punuar me komponentin e teknologjisë së informacionit të regjistrit për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme në funksion të regjistrit. Në këtë kuadër është përgatitur dhe gjeodatabaza e regjistrit dhe transformi i variablave, duke iu përshtatur “Katalogut të Variablave”. Gjithashtu është bërë rishikimi i vazhdueshëm i dokumentave bazë të regjistrit, si dhe janë përgatitur skenarët e ndryshëm (*use cases*) për përditësimin e tij. Përsa i përket klasifikimit statistikor të njësive territoriale është transmetuar në Eurostat lista e njësive administrative lokale LAU (Local Administrative Unit) dhe klasifikimi Degurba (Shkalla e Urbanizimit). Për vitin 2023, informacioni statistikor rajonal dhe gjeoinformacioni kanë kontribuar edhe në publikimin e “Vjetarit Statistikor Rajonal” me përgatitjen e informacionit hartografik dhe shkrimor.

III. Censet

Brenda pesëvjeçarit të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026 është parashikuar zhvillimi i dy censeve: Censi i Popullsisë dhe Banesave dhe Censi i Bujqësisë.

Censi i Popullsisë dhe Banesave

Aktivitetet e Censit ndahen në tre faza kryesore:

1. Faza përgatitore ose para-numërimit
2. Faza e numërimit
3. Faza e pas-numërimit

Në kuadër të menaxhimit dhe organizimit të Censit gjatë vitit 2023 vëmendje e veçantë iu kushtua menaxhimit të cilësisë së proceseve dhe cilësisë së të dhënave, duke mbajtur në vëmendje minimizimin e risqeve që mund të ndikojnë në secilën nga etaprat e këtij aktiviteti madhor dhe me rëndësi të madhe statistikore.

1. Faza përgatitore

Gjatë vitit 2023, INSTAT vijoi punën për fazën përgatitore ose para-numërimit për sigurimin e mbarëvajtjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave, të cilat përmbledhen si vijon:

- Rishikimi i pyetësorëve bazuar në përditësimet e reflektuara gjatë testimeve/trajnimeve të stafit që do të shërbenin si trajnerë master dhe kontrole të kryera periodikisht, në anglisht/shqip, si dhe për Anketën pas Cens (APC).
- U finalizuan pyetësorët e Censit dhe materialet metodologjike si vijon:
 - Manual anketuesi, kontrollori, mbikëqyrësi dhe anketuesi special;
 - Materialet prezantuese për trajnim;
 - Materialet ndihmëse të trajnerëve;
 - Videot prezantuese të cilat bënin të mundur përcjelljen lehtësisht të informacionit në të gjitha sallat e trajnimit, në të gjithë vendin; kjo sidomos për pyetjet sensitive dhe ato më të rëndësishmet të parashikuara në pyetësor;
 - Seksionet e vlerësimit me qëllim marrjen e 'feedback' se sa është përthithur informacioni nga të trajnuarit.
- U finalizua platforma e mbledhjes së të dhënave për njësitë ekonomike familjare, si dhe për banesat kolektive, si dhe konfigurimi i tabletave me përditësimet e reja, për qënien tërësisht funksionale me nisjen e numërimit dhe transmetimin korrekt dhe koherent të të dhënave.
- U kryen përgatitjet logjistike në nivel vendi;
- U intensifikua fushata e komunikimit nëpërmjet faqes zyrtare të institucionit, spoteve në radio/televizione, rrjeteve sociale për rekrutimin e stafit të terrenit.
- U realizuan trajnime sipas një planifikimi me stafin e INSTAT qendër dhe të Zyrave Rajonale me qëllim përvetësimin sa më mirë të njohurive në funksion të Cens 2023, për të qenë të gatshëm si lektorë gjatë trajnimeve që u kryen në të gjitha bashkitë e Shqipërisë, për stafin e terrenit (mbikëqyrës, kontrollor, anketues dhe anketues special).
- U kryen kontrole dhe editime të gjeo-databazës së Censit, në funksion të përmirësimit të kodifikimit të ndërtesave dhe hyrjeve, ku në bashkëpunim dhe me asistencë teknike – kryesisht nga Teknologjia dhe Informacioni – u bë i mundur përditësimi/përmirësimi i aplikacionit mbledhës i të dhënave, përta i takon punës me hartat.
- Lidhur me procesin e rekrutimeve në kuadër të Cens u krijua një aplikacion "Human Resources Management" për menaxhimin e këtij procesi, i cili u finalizua në fillim të vitit 2023. Nëpërmjet këtij aplikacioni u realizua platforma e aplikimit online për të gjitha pozicionet e punës në kuadër të këtij aktiviteti.
- INSTAT mori pjesë në Panairin e Punës gjatë muajit Prill 2023, në vijimësi të fushatës së komunikimit me publikun mbi zhvillimin e Censit, ku u informuan të interesuarit mbi planin e rekrutimeve të nevojshme për zhvillimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave.
- Në zbatim të këtij aktiviteti madhor, me qëllim sigurimin e ambienteve për mbarëvajtjen e Censit, patëm mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Bashkive, Universiteteve, , si dhe u realizuan detyrat e ngarkuara për procedurat e prokurimit të nevojshme për mbështetje logjistike. Para fillimit të numërimit, stafi i terrenit kishte ambientet e nevojshme (Zyra Censi/ambiente trajnimi). Një rol të rëndësishëm në këtë proces, para fazës së numërimit, pati edhe mbështetja nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, duke siguruar mjetet e nevojshme për transportimin e bazës materiale në bashki.

Grupet e synuara	Të trajnuar
Trajnerë të INSTAT*	130
Mbikëqyrësit	170
Kontrollorët	1,156
Anketuesit	5,785
Anketuesit Special	50
Stafi mbështetës i GIS	92
Stafi mbështetës i IT	190

2. Faza e numërimit

- Më 13 Shtator 2023, INSTAT zhvilloi konferencën hapëse të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, ku njoftoi zyrtarisht fillimin e numërimit të popullsisë dhe banesave në terren. Në konferencë morën pjesë kryeministri dhe anëtarë të kabinetit qeveritar, partnerë dhe anëtarë të KQC.
- Mbikëqyrësit, kontrollorët dhe anketuesit e përfshirë në numërim ishin shpërndarë sipas Zonave të Censit të paracaktuara, me mbështetjen e stafit monitorues nga INSTAT qendër dhe Zyrat Rajonale për secilën bashki të Shqipërisë.
- Në kuadër të mbarëvajtjes së procesit u zhvilluan takime periodike në nivel vendor dhe INSTAT qendër nga ku merreshin udhëzime dhe shpjegime metodologjike, të cilat më pas i përcilleshin stafit të terrenit, me qëllim sigurimin e cilësisë në numërim.
- INSTAT qendër vuri në dispozicion të qytetarëve shërbimin 'Call Center' i cili shërbeu gjatë gjithë periudhës së Censit, për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve që kishin nevojë për informacion rreth numërimit apo shpjegimeve metodologjike, ku një rol të rëndësishme kishte edhe lënia e takimeve/orareve me qytetarët dhe mbështetjen nëse ishte e nevojshme nga ana metodologjike për numërim korrekt.
- Mbledhja e të dhënave në terren ishte planifikuar të realizohej gjatë periudhës 18 Shtator deri më 30 Tetor 2023, por për shkak të identifikimit të disa zonave të mbipopulluara (me numër banesash më të larta se planifikimi), si dhe për shkak të banesave pa kontakt ose refuzimeve, lindi nevoja për vazhdimin e procesit deri më datë 15 Nëntor 2023. Njoftimi për shtyp u bë edhe në faqen zyrtare të INSTAT.
- Procesi i grumbullimit të bazës materiale vazhdoi edhe me verifikimet përfundimtare të terrenit;
- Gjatë periudhës 20 Nëntor deri më 20 Dhjetor u zhvillua në terren Anketa pas Cens, qëllimi i së cilës është vlerësimi i mbulimit të Censit dhe vlerësimi i cilësisë së numërimit. APC u zhvillua në 100 Zona Censi të përzgjedhura në të dymbëdhjetë qarqet e vendit.
- Me mbylljen e këtij aktiviteti intensiv të zhvilluar në terren, u organizua një workshop ku u diskutuan problematikat, zgjidhjet, sfidat dhe arritjet gjatë kryerjes së këtij aktiviteti madhor.

3. Faza e pas numërimit

Aktivitetet të planifikuara për vitin 2024

Gjatë vitit 2024 është planifikuar edhe faza e pas-numërimit, e cila do të ketë në fokus aktivitetet si vijon:

- Përgatitja e publikimeve me rezultatet kryesore të Censit, bazuar në planin e tabulimeve, i cili do të mundësojë gjithashtu krahasimin me Censin e kaluar
- Publikimi i rezultateve në nivel kombëtar dhe rajonal, në Qershor të vitit 2024
- Publikimi i rezultateve të detajuara në nivel qarku/bashkie në Tetor të vitit 2024
- Raportime dhe analiza mbi rezultatet e Censit.

Censi i Bujqësisë

Censi i Bujqësisë është planifikuar të zhvillohet në vitin 2024, në përputhje me rekomandimet e FAO-s, për raundin e censeve 2020 dherregulloren e KE 1091/2018 mbi Statistikat e Integruara të Fermave.

Në aspektin e kuadrit rregullator, për kryerjen e Censit të Bujqësisë, INSTAT-i ka draftuar ligjin e Censit të Bujqësisë, i cili është konsultuar në mënyrë të vazhdueshme me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushës.

Gjatë vitit 2023, INSTAT ka vijuar punën përgatitore për realizimin e Censit të Bujqësisë, në bashkëpunim me partnerë kombëtarë, si: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Universiteti Bujqësor të Tiranës, Ministria e Turizmit, Ministria e Financave, etj, dhe me institucione ndërkombëtare si: FAO, EU, Banka Botërore të cilët mbështesin në mënyrë të vazhdueshme me ekspertizë.

Takime të vazhdueshme janë zhvilluar me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), me fokus kryesor vënien në dispozicion të regjistrave administrativë që kjo ministri disponon dhe të cilat do jenë burime shtesë për përcaktimin e metodologjisë që do ndjekë Cens-i.

Nën ekspertizën e FAO-s, janë përgatitur tashmë draft-dokumentat strategjikë të Censit, të tillë si: strategjia, plani i detajuar i aktiviteteve për zbatimin e strategjisë dhe draft-buxheti. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka shprehur paraprakisht gatishmërinë për të mbështetur INSTAT në këtë aktivitet madhor dhe të rëndësishëm, duke kontribuar me regjistra dhe me burime njerëzore, për periudhën e terrenit. INSTAT ka bashkëpunuar me këtë Ministri, si partneri kryesor në këtë aktivitet të rëndësishëm, për të finalizuar dokumentat strategjikë të Cens-it së bashku dhe draft-pyetësin e Cens-it të Bujqësisë 2024. Finalizimi i dokumentave strategjikë do të shërbejë për të planifikuar elementët më të rëndësishëm të projektit, duke filluar me përgatitjen e kuadrit rregullator, vlerësimin e burimeve dhe aktorëve që do të përfshihen më tej, si dhe përcaktimin e metodologjisë që do të ndiqet.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbarëvajtjes së Censit, në Maj 2023, u nënshkrua një memorandum bashkëpunimi ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Mbështetja e partnerëve nëpërmjet asistencës teknike ka qenë e vazhdueshme. Në muajin Nëntor 2023 u zhvillua një mision i organizuar nga FAO, me një ekspertizë për përdorimin e regjistrave administrative, në kuadër të ndërtimit të kornizës mbi të cilën do të organizohet Censi i Bujqësisë. Nga ky mision u adresua rekomandimi kryesor, i cili theksonte se burimi kryesor për krijimin e kornizës së NJEB-ve do të jenë të dhënat e përfuara nga moduli i bujqësisë, i përfshirë në pyetësin e Censit të Popullsisë dhe Banesave. Regjistrat administrativë do të përdoren si burim suplementar.

Komisioni Evropian ka mbështetur INSTAT-in nëpërmjet asistencës teknike për realizimin e Censit të Bujqësisë, i cili është fokusuar në dy komponentë:

- aspektet metodologjike, duke përfshirë përgatitjen e pyetësit të Censit të Bujqësisë;
- mbështetje në zhvillimin e një aplikacioni për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë, duke përdorur metodën CAPI (intervistë personale me ndihmën e kompjuterit).

IV. Veprimtaria e Institutit të Statistikave – INSTAT

Historiku, vizioni, misioni, vlerat

INSTAT-i është institucioni prodhues kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, i themeluar në vitin 1993 në zbatim të ligjit nr. 7687, datë 16.03.1993 “Për statistikën”. Në atë kohë, Instituti i Statistikave ishte institucion qendror në varësi të Këshillit të Ministrave, i cili kishte për kompetencë të miratonte numrin e punonjësve të drejtorive apo sektorëve të statistikës në ministri e institucione qendrore si dhe drejtorive të statistikës në rrethe. Në varësi të drejtpërdrejtë të Institutit të Statistikës u krijuan drejtoritë e statistikës në rrethe ndërkohë që drejtori i Institutit të Statistikës miratonte drejtorët ose përgjegjësat dhe punonjësit e statistikës në ministri apo institucionet e tjera qendrore, me propozim të

titullarit përkatës.² Këshilli i Statistikës ishte organ konsultativ, drejtohej nga drejtori i Institutit të Statistikës, i cili miratonte edhe përbërjen e këtij Këshilli.

Në vitin 2004, në zbatim të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikave zyrtare”, për herë të parë në legjislacionin e statistikave zyrtare u përfshinë detyrimet e prodhuesve të statistikave zyrtare për zbatimin e parimeve të statistikave zyrtare sipas *acquis communautaire*. Instituti i Statistikës u quajt “Instituti i Statistikave” dhe mori akronimin “INSTAT”. Me ndryshimet që pësoi ligji në vitet 2010-2013, u formalizua për herë të parë “Sistemi Kombëtar Statistikor” dhe INSTAT u ngarkua me detyrën e koordinatorit të këtij sistemi. INSTAT u pozicionua në varësi të Kryeministrit dhe punonjësit u bënë pjesë e shërbimit civil. Këshilli i Statistikave mori kompetenca vendimmarrëse, ku vlen të përmendet detyrimi për kryerjen e një procedure publike rekrutimi për titullarin e INSTAT-it dhe propozimin e kandidatëve Kryeministrit për emërim. Për herë të parë Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohej për një kohë të caktuar prej 5 vjetëve, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.³

Sipas ligjit të vitit 2004, për herë të parë prodhuesit e statistikave u detyruan të operonin sipas një programi pesëvjeçar të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili përkon me periudhën 2007-2011.

Në vitin 2018, legjislacioni për statistikave zyrtare u rishikua në tërësinë e tij me qëllim përafrimin e plotë me kërkesat e Rregullores (KE) 223/2009 “Për statistikave evropiane”. Ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare” përafroi jo vetëm standardet e kësaj rregullore, por edhe parimet e statistikave zyrtare të parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Për të garantuar pavarësinë profesionale dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistika, INSTAT u krijua si institucion i pavarur i cili i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it u ngarkua të përfaqësojë Sistemin Kombëtar Statistikor, si dhe të nxirrte udhëzime e standarde për prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, me qëllim që të sigurohej zbatimi i parimeve të statistikave zyrtare sipas neneve 4 dhe 5 të ligjit të lartpërmendur. Këshilli i Statistikave rimori kompetencën e një organi këshillues. Kuvendi i Shqipërisë emëron Drejtorin e Përgjithshëm në vijim të një procedure publike transparente përzgjedhje. Programi pesëvjeçar zbatohet sipas një Plani Vjetor i cili gjithashtu miratohet nga Kuvendi.

Sipas raporteve të tyre periodike të progresit, reforma legjislative për prodhimin e statistikave zyrtare në vend është mirëpritur nga Eurostat dhe Komisioni Evropian.

Misioni, Vizioni, Vlerat

Misioni

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Vlerat

²Neni 7 i Ligjit nr.7687, datë 16.03.1993 “Për statistikën”

³Neni 9 i Ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikave zyrtare”, i ndryshuar

Profesionalizmi:

- Besueshmëria
- Objektiviteti
- Bashkëpunimi dhe Komunikimi
- Identifikimi me INSTAT
- Të qënurit i orientuar ndaj përdoruesve
- Të qënurit i orientuar ndaj cilësisë
- Orientimi ndaj zgjidhjeve
- Iniciativa
- Përgjegjshmëria

Integriteti:

- Respekti ndaj njëri tjetrit
- Dinjiteti
- Barazia
- Respektimi i mendimit ndryshe
- Mbështetja ndaj njëri tjetrit
- Shkëmbimi i njohurive

Motivimi:

- Përfshirja në procese
- Fleksibiliteti
- Dhënia e *feedback*
- Qëndrueshmëria

Integrimi Evropian

INSTAT po punon intensivisht në kuadër të zbatimit të hapave drejt Integritit Evropian. Pas marrjes së raportit *screening* të Komisionit Evropian, për Kapitullin 18 “Statistikat”, INSTAT ka përgatitur Pozicionin Negociues për Kapitullin 18, ku bazuar në gjetjet e Komisionit dhe gjetjet e takimit bilateral, ka përgatitur për çdo fushë dhe nënfushë të Kapitullit planet konkrete për arritjen e standardeve evropiane dhe përafrimin me EU *acquis*.

Duke qenë se për Kapitullin 18 mbi “Statistikat” kërkohet një transpozim në legjislacionin kombëtar, INSTAT ka përfshirë 2 projekt udhëzime të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT dhe 1 projektligj në Planin Kombëtar të Integritit Evropian (PKIE) në 2023-2025.

Gjatë vitit 2023 janë miratuar në mbledhjen Bordit Drejtues të INSTAT, më datë 11.12.2023, Udhëzimi “Për zbatimin e parimeve për matjen e Çmimeve dhe Vëllimeve në Llogaritë Kombëtare” dhe Udhëzimi “Për vrojtimit statistikore të qumështit dhe të nënprodukteve të tij”, ndërkohë projektligji për “Censin e Bujqësisë” është propozuar për t’u miratur në katërmujorin e parë të vitit 2024.

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndër-institucionale të punës për integrimin Evropian”, INSTAT gjatë vitit 2023 ka zhvilluar takime periodike sipas kalendarit të parashikuar në Paketën e Semestrit dhe Integritit Evropian PSIE, aneksi 1, paketa 2, mbi kalendarin vjetor të punës së GNPIE-së, duke kryer analizën dhe planifikimin për përafrimin e akteve komunitare.

Gjithashtu, mbështetur në VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, INSTAT ka përditësuar listën e anëtarëve të “Tryezës së Diskutimit “Statistikat” për Kapitullin 18, me 11 përfaqësues nga shoqëria civile, shoqatat e biznesit dhe bota akademike, të cilët kanë shprehur interes dhe janë bërë pjesë e kësaj tryeze për të kontribuar në kuadër të Platformës së Partneritetit Publik për Integrimin Evropian. Gjatë vitit 2023, INSTAT-i organizoi takime konsultuese dhe informative me këtë temë diskutimi.

Gjatë vitit 2023, INSTAT në cilësinë e anëtarit të grupit negociator përgjegjës për Kapitullin 18 “Statistikat” ka marrë pjesë dhe ka kontribuar rregullisht në takimet periodike të Grupit Negociator, si dhe ka kryer raportimet javore dhe tremujore pranë Kryenegociatorit për rezultatet e arritura dhe problematikat.

Për zbatimin e këtyre rekomandimeve, INSTAT ka ndërmarrë hapa konkretë, të cilat janë përfshirë në Planin Operacional të vitit 2024.

Sipas Progres Raportit 2023 për Shqipërinë, Kapitulli 18, publikuar nga Komisioni Evropian në Nëntor 2023, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për statistikave. INSTAT ka bërë progres në adresimin e rekomandimeve të raportit të vitit 2023. Gjatë kësaj periudhe është bërë harmonizimi i mëtejshëm me standardet e Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare (ESA 2010), publikimi i statistikave është bërë më i shpejtë dhe ka pasur rritje të transmetimit në Eurostat. Parlamenti miratoi planin vjetor statistikor 2023, duke përfshirë datën për Censin e popullsisë dhe banesave. Roli i Institutit të Statistikave (INSTAT) u forcua më tej dhe burimet e tij u përmirësuan, por zhvillimi i kapaciteteve vazhdon të jetë një sfidë. Pavarësisht progresit të bërë në modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar proceset e prodhimit statistikor. Rekomandimet e lëna në vitin 2023 në shumicën e tyre mbeten të vlefshme.

Për vitin në vijim janë lënë rekomandimet e mëposhtme;

- Shqipëria duhet të shpërnda në kohën e duhur rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe të përgatisë një plan të përditësuar, të sigurojë burimet dhe të jetë e gatshme të zbatojë Censin e fermave bujqësore në përputhje me acquis përkatëse të BE-së dhe standardet ndërkombëtare;
- të marrë masa për të reduktuar qarkullimin e stafit në mënyrë që të sigurohet plotësimi i nevojave të prodhimit statistikor;
- të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë për shpërndarje nga Eurostat, dhe në veçanti të bëjë publike të dhënat e statistikave të financave të qeverisë (GFS).

Sipas këtij progres raporti, lidhur me infrastrukturën statistikore, ligji për statistikave zyrtare në Shqipëri është në përputhje me Kodin e Praktikës Statistikore Evropiane dhe shumica e klasifikimeve janë në përputhje me standardet e BE-së. Programi i Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026 është duke u zbatuar. Planin Vjetor 2023 është miratuar në Kuvend në Janar 2023, plan i cili përmban dhe datën e Censit të Popullsisë dhe Banesave, i parashikuar për t'u realizuar në vitin 2023, pas shtyrjes tashmë dy herë. Ndërsa INSTAT ka bërë disa përpjekje për të plotësuar vendet vakante dhe synon të rrisë nivelet e personelit nga 236 në 266 deri në vitin 2026, duhen bërë përpjekje të tjera për të zvogëluar lëvizjet e stafit, për të siguruar që nevojat e prodhimit janë të mbuluara dhe për të trajnuar personelin e ri me zhvillimet statistikore më të fundit.

Në lidhje me fushën e statistikave makroekonomike, ky raport cilëson se të dhënat e prodhuara për PBB-në vjetore dhe tremujore janë në përputhje me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, ndërkohë në Llogaritë Kombëtare, për llogaritë kombëtare tremujore dhe vjetore (agregatët kryesore), për tabelat burim-përdorim, Tabelat input-output, dhe për llogaritë rajonale, Shqipëria është pjesërisht në përputhje me ESA 2010. Transmetimi i të dhënave tek Eurostat është përmirësuar gradualisht në terma kohor për llogaritë kombëtare vjetore. Megjithatë, ka nevojë ende për përmirësime të konsiderueshme për të arritur përputhjen e plotë (kryesisht në qasjen për PBB-në tremujore sipas të ardhurave dhe të dhënave për popullsinë dhe punësimin). Pavarësisht progresit në përshtatjen me standardet e ESA 2010, Shqipëria ende ka nevojë të përmirësojë përputhshmërinë me kërkesat metodologjike dhe të zbatojë përmirësimet që ka arritur deri tani në rishikimin e mëtejshëm të ndjekur në vitin 2024. Inventari i Produktit të Brendshëm Bruto, i cili përshkruan burimet dhe metodat e përdorura për përpilimin e llogarive kombëtare, duhet të përditësohet. Nevojiten përpjekje për të siguruar kompleksitetin e tabelave të njoftimit mbi procedurën e deficitit tejkaluar, të cilat dërgohen rregullisht në Eurostat, duke u bazuar në përpjekjet më të mira. Gjithashtu, duhen bërë përmirësime në statistikën financiare të qeverisë për të përmbushur kërkesat e *acquis* të BE-së dhe të dhënat të bëhen të disponueshme publikisht. Kërkohej gjithashtu një përpjekje e madhe për të përmirësuar kohën, mbulimin dhe cilësinë e llogarive vjetore të sektorit jo-financiar dhe llogarive vjetore të sektorit financiar, dhe për të filluar përpilimin e llogarive çdo tremujor edhe për sektorin jo-financiar. Përpjekjet janë të nevojshme për të nisur punën për përpilimin e tabelës së të drejtave të pensionit.

Në lidhje me fushën e Statistikave Ekonomike dhe Sektorale, ky progres raport thekson se mbledhja e të dhënave dhe prodhimi i statistikave të biznesit është përmirësuar dhe INSTAT vazhdon të arrijë norma të larta të përgjigjeve në anketat e biznesit dhe të familjeve. Raporti cilëson se për të gjitha fushat e statistikave afatshkurtra (STS) (industria, ndërtimi, tregtia me shumicë dhe shërbimet e tjera), Shqipëria është pjesërisht e përputhur dhe disa tregues të statistikave afatshkurtra ende nuk transmetohen në Eurostat. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të transmetuar statistikën e demografisë së biznesit. Ndërkohë raporti thekson se statistikën mbi koston e punës llogariten bazuar në anketën e kostonë së punës. Në lidhje me anketën e forcave të punës, kjo anketë kryhet rregullisht dhe mikrodatat dërgohen në Eurostat. Gjithashtu raporti thekson se statistika mbi vendet vakante akoma nuk prodhohen.

Në fushën e statistikave demografike dhe sociale, progresi raportit thekson se INSTAT vazhdon të kryejë anketën e të ardhurave dhe nivelit të jetesës (SILC) dhe të dhënat janë verifikuar dhe publikuar nga Eurostat. Statistikat mbi migracionin dhe azilin janë pjesërisht në përputhje me *acquis*-in e BE-së. Statistikat mbi krimin publikohen çdo vit dhe bazohen plotësisht në burimet administrative. Statistikat e krimit në Shqipëri klasifikohen në bazë të Kodit Penal kombëtar dhe ligjeve, por INSTAT është duke punuar në një hartëzim që përdor Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për Qëllime Statistike. Në lidhje me mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë ka përmirësim, ku Programi i Statistikave Zyrtare përfshin dispozita të veçanta për mbledhjen dhe analizimin e statistikave gjinore. Megjithatë, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të prodhuar të dhëna të ndara për grupe të caktuara.

Në lidhje me Censin e Popullsisë dhe Banesave përmendet zbatimi i tij në vitin 2023, pas shtyrjes dy herë dhe pas një piloti të dytë që çoi në përmirësime të mëtejshme. Theksohet se mbështetja financiare duhet të jetë e mjaftueshme për zbatimin e tij dhe të përdoren të dhënat administrative kur është e mundur, gjithashtu kërkohet garantimi i rishikimit të të dhënave.

Në lidhje me fushën e Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain, progresi raportit vlerëson se statistikën e bujqësisë janë pjesërisht në përputhje me *acquis*-in e BE-së. Është bërë disa progres në regjistrat administrative, si: regjistri i fermerëve, regjistri individual i kafshëve dhe regjistri i pronës së kafshëve, por cilësia e të dhënave ende ka nevojë për përmirësim. Cilësohet kërkesa për përfundimin e dokumentacionit

të nevojshëm për Censin e Bujqësisë të planifikuar për vitin 2024, duke përfshirë një plan veprimi dhe një buxhet të përditësuar dhe të sigurojë fondet e nevojshme për ta kryer me sukses dhe miratimi i aktit ligjor të nevojshëm për të garantuar përputhshmërinë me rregulloret e BE-së për statistikën e integruara të fermerisë.

Statistikat e mjedisit janë pjesërisht në përputhje me *acquis*-in e BE-së. Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore janë të përputhura mirë me *acquis*. Llogaritjet e emetimeve të ajrit, llogaritë e flukseve fizike të energjisë dhe taksat mjedisore sipas aktivitetit ekonomik mbeten pjesërisht në përputhje me kërkesat e BE-së. Statistikat e mbetjeve janë përmirësuar, por ende nuk janë plotësisht në përputhje. Të dhënat mbi mbetjet e paketimit janë gjithnjë e më të rëndësishme, pasi ato janë baza për një burim të ri të BE-së për mbetjet e paketuara plastike të pa-ricikluara. Shqipëria tashmë mbledh të dhëna mbi mbetjet në nivel bashkie, por ka nevojë për të mbledhur dhe transmetuar statistikën mbi mbetjet industriale dhe siguruar një vlerësim të përgjithshëm të të gjitha mbetjeve të paketuara plastike që prodhohen dhe riciklohen.

Statistikat e energjisë janë pjesërisht të përputhura me *acquis*-in e BE-së. INSTAT dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore prodhojnë statistika mujore dhe vjetore të energjisë për bilancin e të gjitha produkteve të energjisë (karburantet) të përdorura në Shqipëri (gazi natyror dhe nafta), si dhe çmimet e energjisë për familjet dhe industrinë. Është e nevojshme një përpjekje e madhe për të arritur një përputhje të plotë me *acquis* të statistikave të energjisë.

Gjatë vitit 2023, INSTAT ka kontribuar në Nënkomitetet e mëposhtme:

- Nënkomiteti i 15-të, i Çështjeve Ekonomike Financiare dhe Statistikat, ECOFIN
- “Bujqësia dhe Peshkimi”
- “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet”
- “Drejtësia, Liria dhe Siguria”
- “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale.

Për sa më sipër, Nënkomiteti i 15-të, i Çështjeve Ekonomike Financiare dhe Statistikat, ECOFIN organizuar më datë 9 Nëntor 2023, INSTAT raportoi mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave, përgatitjet për Censin e Bujqësisë, si dhe plotësimin e vendeve vakante. Në mbarim të këtij takimi u dhanë rekomandimet e mëposhtme të cilat janë në linjë dhe me rekomandimet e Progres Raportit.

- Shqipëria duhet të vazhdojë të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë në Eurostat, duke përdorur të njëjtat mjete dhe kalendar si vendet anëtare të BE-së.
- Shqipëria duhet të vazhdojë të përparojë në Llogaritë Kombëtare dhe njoftimet EDP, si dhe Revizionimin e Llogarive Kombëtare, në vitin 2024.
- Në tremujorin e katërt 2023, Shqipëria duhet të organizojë Censin e Popullsisë dhe Banesave, duke i dorëzuar Eurostatit një grup të parë të dhënash deri në Dhjetor 2024 dhe të dhënat e detajuara deri në Prill 2025.
- Në nënkomisionin e ardhshëm ECOFIN, do të jetë i miratuar Ligji për Censin e Bujqësisë dhe Shqipëria do të ketë një plan dhe buxhet të qartë për zbatimin e tij.

INSTAT ka përfshirë rekomandimet e Progres Raportit dhe Nënkomiteteve në planin operacional me detyra të mirëpërcaktuara për zbatimin e tyre.

Të udhëhequr nga objektivi strategjik “Fuqizimi i rolit të INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare”, INSTAT vazhdon të angazhohet në paraqitjen e

raporteve, mendimeve dhe studimeve në arenën ndërkombëtare në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor, duke marrë pjesë dhe kontribuar në forume dhe aktivitete të ndryshme botërore të statistikave.

Në nivel kombëtar, INSTAT ka kontribuar në hartimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim; strategjitë sektoriale; hartimin e strategjisë S3, grupe ndëstinucionale, në mbështetje të vazhdueshme të nevojave kombëtare për të dhëna statistikore zyrtare.

Në kontekstin Evropian, INSTAT organizoi në datat 8-9 Nëntor 2023 në Tiranë, në bashkëpunim me Eurostat, takimin e përvitshëm të Grupit të Politikave për Bashkëpunimin Statistikor (PGSC), me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, vendet e Evropës Lindore dhe DG Near. Në këtë takim ndër të tjerë u theksuan dhe arritjet e INSTAT në nivel rajonal.

INSTAT bashkëdrejtoi takimin dhe prezantoi çështjet si më poshtë:

- Zhvillimet më të fundit mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave dhe planin e punës për të siguruar shpërndarjen në kohë të të dhënave;
- Zhvillimet më të fundit mbi përgatitjet për realizimin e Censit të Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore;
- Sigurimi dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat dhe progresi nga viti i kaluar.

Në nivel ndërkombëtar, INSTAT jep kontributin e vazhdueshëm në takimet periodike të organizuara nga Kombet e Bashkuara, në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ndërtim të kapaciteteve për statistikat, Axsenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm – HLG PCCB, ku Shqipëria është anëtare dhe bashkëdrejtuese e këtij takimi prej vitit 2019; në Komitetin e Programit për organizimin e tre Forumeve Botërore të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara. Gjatë vitit 2023, Shqipëria u propozua dhe u bë bashkëdrejtuese e Byrosë së Konferencës së Statisticienëve Evropianë të UNECE për vitet 2023-2025. Gjithashtu, vendi ynë është anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare për Statistikat Zyrtare për vitet 2023-2025.

Një rol të rëndësishëm, INSTAT ka mbajtur në hartimin e Raportit të Konkurrueshmërisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga OECD dhe koordinuar në nivel vendi nga Ministria e Financave, ku Shqipëria është vlerësuar pozitivisht, si nga ana e treguesve cilësorë dhe atyre sasiorë.

Koordinimi i Projekteve

Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit të statistikave zyrtare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga Bashkimi Evropian, Sida (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO) dhe Kombet e Bashkuara. Në vijim paraqitet informacioni më i detajuar në lidhje me ecurinë e këtij bashkëpunimi gjatë vitit 2023, dhe sektorët ku është fokusuar mbështetja.

1) Granti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri, IPA kombëtare 2014”

Projekti IPA kombëtare ka mbështetur aktivitetet të Censit të Popullsisë dhe Banesave përmes sigurimit të asistencës teknike, fushatës publitare, rritjes së kapaciteteve të stafit të INSTAT-it dhe sigurimit të bazës IT.

Bazuar në detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen Operacionale ndërmjet INSTAT, Koordinatorit Kombëtar të IPA (KKIPA) dhe Njesisë për financimet dhe kontraktimet (CFCU), nëpërmjet njesisë IPA, INSTAT ka kontribuar në realizimin e aktiviteteve përkatëse si më poshtë:

- ka raportuar pranë Ministrisë së Financave, njësisë për financimet dhe kontraktimet (CFCU) dhe pranë Agjencisë Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) mbi progresin e zbatimit të aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave përmes raporteve mujore, 3-mujore dhe 6 mujore dhe raporteve vjetore.
- ka përgatitur dhe dërguar pranë autoritetit kontraktues/CFCU raportet narrative dhe financiare 6 mujore të kontratës së Grantit.
- ka monitoruar procedurat e prokurimit të kryera gjatë këtij viti, ka përgatitur dhe monitoruar procesin e çertifikimit 'ex-post' të procedurave të prokurimit të financuara nga fondet e Bashkimit Evropian.

2) Kontratë Shërbimi “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri”

Kontrata e shërbimit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri,” është pjesë e kontratës së Grantit. Periudha e zbatimit të kësaj kontratë është 21.06.2019-20.06.2024.

Qëllimi i kontratës është të mbështesë INSTAT-in me asistencë teknike për realizimin e aktiviteteve të Censit. Kontrata është në fazën e zbatimit të saj. Gjatë vitit 2023 Njësia IPA në INSTAT ka koordinuar punën ndërmjet asistencës teknike dhe grupit të punës për menaxhimin e këtij aktiviteti madhor. Gjatë vitit 2023, ekspertët e asistencës teknike kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm me INSTAT për të ndjekur aktivitetet e kontratës ku janë diskutuar problematikat dhe marrjen e masave për mitigimin e tyre. Më 14 Nëntor 2023 u mbajt takimi i Komitetit Drejtues të Kontratës së Asistencës Teknike. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i ecurisë së projektit për periudhën raportuese Korrik 2022-Qershor 2023 ku u mbajt një prezantim mbi ecurinë e procesit të mbledhjes së të dhënave të Cens në terren.

Më 15.06.2023 është nënshkruar Amendimi Nr. 6 i Kontratës së Asistencës Teknike. Ndryshimet janë fokusuar në buxhetin total të kontratës dhe në një shtyrje prej 12 muajsh të periudhës së zbatimit të kontratës.

3) Programi i Bashkëpunimit Statistikor ShumëPërfitues – IPA 2019

Programi i bashkëpunimit statistikor shumë-përfitues IPA 2019 siguron mbështetje statistikore nëpërmjet asistencës teknike dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit të INSTAT dhe Sistemit Kombëtar Statistikor në tërësi. Periudha e zbatimit të kontratës ka filluar më 01.09.2021 dhe përfundon më 31.03.2024. Objektivi i përgjithshëm i programit është të përgatisë Sistemin Statistikor në Shqipëri në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian duke përshtatur metodologjitë me *acquis communautaire*, duke i integruar dhe harmonizuar ato në Sistemin Evropian të Statistikave.

Programi përfshin komponentët sipas projekteve të mëposhtme statistikore:

1. Projekti Statistikor 1.1 “Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Deficitit të Tejkalluar;
2. Projekti Statistikor 2.1 “Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (HICP)” dhe “Indeksi i Çmimeve të Banesave (HPI)”;
3. Projekti Statistikor 2.2 “Statistikat e Çmimeve”;
4. Projekti Statistikor 3.2 “Statistikat Afatshkurtra të Biznesit”;
5. Projekti Statistikor 4.1 “Anketa e Forcës së Punës”;
6. Projekti Statistikor 5.5 “Llogaritë Ekonomike në Mjedis”;
7. Projekti Statistikor 5.6 “Statistikat e Mbetjeve”;
8. Projekti Statistikor 6.1 “Menaxhimi i Cilësisë”;

9. Projekti Statistikor 6.2 “Metadata”;

Gjatë vitit 2023, programi IPA 2019 ka mbështetur INSTAT-in përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit të INSTAT, në përmirësimin e mëtejshëm të zbatimit të rekomandimeve bazë dhe metodologjisë në transmetimin e vazhdueshëm të të dhënave në lidhje me Statistikat e Financave të Qeverisë (GFS) dhe statistikave të Deficitit të Tejkuluar (EDP), Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumit (HICP) dhe Indeksi i Çmimeve të Banesave (HPI), Matja e fuqisë blerëse (PPP), Statistikat Afatshkurtra të Biznesit, Anketa e Forcave të Punës, Llogaritë Ekonomike në Mjedis, Statistikat e Mbetjeve, si dhe menaxhimin e cilësisë së të dhënave dhe metadatave.

4) Programi i Bashkëpunimit Statistikor ShumëPërfitues – IPA 2022

Më datë 22.12.2023, është nënshkruar kontrata e Grantit Nr. 2023.0333 Programi i Bashkëpunimit Statistikor ShumëPërfitues IPA 2022. Mbështetja fokusohet në 15 fusha statistikore kundër një prej të cilave përfitues është Banka e Shqipërisë. Mbështetja do të ofrohet përkatësisht për Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Deficitit të Tepërt, Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumatorit (HICP) dhe Indeksi i Çmimeve të Banesave (HPI); Matja e fuqisë blerëse (PPP), Statistikat Afatshkurtra të Biznesit, Statistikat e Transportit, Statistikat Strukturore të Biznesit, Anketa e Forcës së Punës, Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës, Sistemi i Integruar Europian për Mbrojtjen Sociale, Llogaritë Ekonomike në Mjedis, Statistikat e ujit, Menaxhimi i Cilësisë, Zhvillimi i Qëndrueshëm, Statistikat e qytetit/informacioni gjeografik, si dhe Investimet e huaja direkte (përfitues i të cilës është Banka e Shqipërisë).

INSTAT ka përgatitur paketën e aplikimit e cila është përcjellë pranë Eurostatit më datë 18.07.2023. Mbështetja fokusohet në cilësinë e prodhimit të statistikave dhe transmetimit të të dhënave, sigurimin e ekspertizës dhe rritje të kapaciteteve të stafit të INSTAT.

5) Projekti “Financim direkt për të mbështetur INSTAT për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022”, mbështetur nga Sida

Në kuadër të kontratës së Grantit Nr. 12550 nënshkruar ndërmjet Ambasadës Suedeze dhe INSTAT-it me objekt “Financimin e drejtpërdrejtë për të mbështetur INSTAT-in për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022”, më datë 24.01.2024 është nënshkruar amendimi Nr. 2 i marrëveshjes i cili përfundon më 30.06.2025. Gjatë vitit 2023 mbështetja është fokusuar në procesin e mbledhjes së të dhënave, pagesën e kontrollorëve të Cens, pagesën e kontratës së auditit për verifikimin e shpenzimeve, si dhe janë finalizuar me sukses procedurat e prokurimit me objekt printime, materiale të brenduara me logon e Cens, si dhe kutitë për paketimin e materialave të Cens.

6) Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare (SALSTAT)

Projekti “Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare” (SALSTAT) është pjesë e programit “Bashki të Forta” financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. SALSTAT-i është një projekt bashkëpunimi ndërmjet Zyrës Statistikore Federale Zviceriane dhe INSTAT-it, me qëllim sigurimin e përmirësimit të statistikave në nivel lokal dhe rajonal, në mënyrë që bashkitë t’i ofrojnë qytetarëve shërbime efektive, eficiente dhe gjithëpërfshirëse. Projekti ka filluar periudhën e dytë të zbatimit nga viti 2022 deri në vitin 2026. Në kuadër të fazës së re, SALSTAT ka vazhduar të intensifikojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare për të forcuar besimin të statistikave zyrtare dhe për të përfshirë palët e interesit në një diskutim lidhur me përfitimet nga statistikave zyrtare, qeverisjen demokratike dhe procesin e vendimmarrjes, veçanërisht sa i përket përmbushjes së detyrave, përgjegjësisë dhe funksioneve të bashkive.

Gjatë vitit 2023, projekti ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkive mbi njohuritë mbi statistikën zyrtare dhe Sistemin Kombëtar Statistikor, si dhe ka siguruar videoprojektorë, printera dhe mirëmbajtjen e lokacionit sekondar (*back up maintaince*) për Pilotin e dytë të Cens-it. Gjithashtu, projekti ka kontribuar në përgatitjen e publikimit të Raportit Vjetor Rajonal të vitit 2020 dhe 2021. Gjatë vitit 2023 ka vijuar mbështetja e ekspertëve të Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës për hartimin e Vjetarit Rajonal (VSR) të INSTAT për vitin 2023, si dhe ekspertit të Regjistrit të Banesave dhe Ndërtesave të Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës. Projekti ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkive si dhe stafit të Zyrave të Gjendjes Civile, përmes trajnimeve për përmirësimin e Statistikave Vitale (Qarku Durrës dhe Fier), si dhe trajnim i avancuar për përdorimin e Microsoft Excel dhe ka siguruar videoprojektorë, printera dhe mirëmbajtjen e lokacionit sekondar (*back up maintaince*).

7) Asistencë Teknike – Censi i Bujqësisë

Për realizimin me sukses të Censit të Bujqësisë, INSTAT ka kërkuar mbështetje ad-hoc nga Bashkimi Evropian. Më datë 18 Dhjetor 2023, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë ka nënshkruar një marrëveshje kuadër me një kohëzgjatje prej 18 muajsh. Qëllimi i kësaj kontrate është ofrimi i asistencës teknike për INSTAT për realizimin e Censit të Bujqësisë i fokusuar në dy komponente:

- aspektet metodologjike, duke përfshirë përgatitjen e pyetësorit të Censit të Bujqësisë;
- mbështetje në zhvillimin e një aplikacioni për grumbullimin e të dhënave të Censit të Bujqësisë duke përdorur CAPI (intervistë personale me ndihmën e kompjuterit).

V. Menaxhimi i Cilësisë

INSTAT-i synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore në përputhje me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. Në përputhje me ligjin për statistikën zyrtare, INSTAT-i përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikën të jenë sa më të përditësuar. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT-i ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane (*European Statistics Code of Practice*).

Gjatë vitit 2023, në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore, puna është fokusuar në hartimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Statistikor Evropian. Në përputhje me nenin 5 të ligjit për statistikën zyrtare, INSTAT-i ka vazhduar iniciativat si: dokumentimi i proceseve statistikore sipas Modelit për Planifikimin e Fazave të Prodhimit Statistikor (GSBPM) dhe kryerja e auditit statistikor.

Në përputhje me parimin 9 të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane mbi “Ngarkesën ndaj të intervistuarve”, INSTAT monitoron nëpërmjet dy treguesve bazë që janë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen dhe kohëzgjatja e intervistës. INSTAT ka punuar për të ndërtuar një sistem, i cili mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore, i cili është në përputhje me parimin nr. 10 të Kodit të Praktikave Evropiane mbi “Kosto dhe Efektivitetin”, dhe në përmbushje të rekomandimit nr. 19 të Peer Review 2018 mbi krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore për qëllime menaxhimi duke përfshirë krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit.

Për vitin 2024, INSTAT-i do të punojë për hartimin/përditësimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Stafi i INSTAT-it dhe i agjencive statistikore do të trajnohet, në lidhje me zbatimin e standardeve sipas GSBPM, si dhe menaxhimin e cilësisë, të cilat shërbejnë për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara dhe në sigurimin e cilësisë statistikore.

Me qëllim rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikën zyrtare, për vitin 2024, parashikohet të vazhdohet puna me publikimin e raporteve të cilësisë, kryerjen e vetëvlerësimeve dhe auditit statistikor. Në fund të procesit të vetëvlerësimit apo auditit statistikor do të vlerësohen situatat problematike dhe do të sugjerohet gjetja e rrugëve për përmirësimin e procesit të prodhimit statistikor.

Dokumentimi i proceseve statistikore

Për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara, INSTAT-i zbaton sistemin GSBPM. Ky model përshkruan dhe përcakton tërësinë e proceseve të nevojshme për t'u ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar.

Gjatë vitit 2023, INSTAT-i ka përdorur versionin më të ri të modelit GSBPM (Versioni 5.1), i cili thekson më shumë rëndësinë e procesit të integritetit të të dhënave statistikore në të gjitha të dhënat në dispozicion. Gjatë këtij viti, ka vazhduar procesi i dokumentimit të aktiviteteve statistikore, të cilat ndjekin këtë model dhe duke e rritur në 83 numrin e aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM.

Auditi Statistikor

Mbështetur në pikën 3 të nenit 17 të ligjit për Statistikat Zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT mund të kryejë auditime statistikore tek prodhuesit e statistikave zyrtare, kur e gjykon të arsyeshme. Auditit statistikor është rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo aktiviteti statistikor, nëpërmjet të cilit identifikohen pikat e forta dhe përmirësohen pikat e dobëta të komponentëve të tij. Auditimi kryhet nëpërmjet një procesi sistematik, të programuar, të pavarur dhe të dokumentuar në të cilin bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin kryesor rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, për vitin 2023, është ndjekur plotësimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit për 1 aktivitet statistikor: "Tabelat burim-përdorime".

Raportet e Cilësisë

INSTAT ka publikuar për përdoruesit Raportet e Cilësisë në nivelin e aktiviteteve statistikore. Në vitin 2023 janë publikuar 56 raporte në faqen elektronike të INSTAT-it, me një rritje prej rreth 7.6 % krahasuar me vitin 2022 ku numri i raporteve të publikuara ishte 52. Raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë statistikore të përdorura për mbledhjen dhe gjenerimin e statistikave zyrtare. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion mbi format dhe standardet që INSTAT përdor në metodat dhe përkufizimet e aplikuara, si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e aktiviteteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Ngarkesa e të Intervistuarve

Anketat pranë ndërrmarjeve

Ngarkesa e të intervistuarve është koha dhe përpjekjet e të anketuarve për t'ju përgjigjur pyetësorëve të INSTAT në mënyrë të kënaqshme për një aktivitet statistikor. Në vitin 2023 janë anketuar në 15 vrojtimet

pranë ndërmarrjeve rreth 25103 ndërmarrje, si dhe në 7 vrojtime realizuar pranë familjeve janë intervistuar rreth 51133 Njësi Ekonomike Familjare.

Statistikat pranë ndërmarrjeve dhe familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuarve (Response burden): numrin e pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Të gjitha anketat pranë ndërmarrjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2023 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2023, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimet pranë ndërmarrjeve ekonomike që realizon INSTAT.

Tabela 2: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Grup_Size	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11 + pyetësorë	Total
1_9 të punësuar	183.103	15.907	319	1.170	200.499
10_19 të punësuar	454	2.861	600	350	4.265
20_49 të punësuar	499	1.227	745	393	2.864
50 + punësuar	511	221	467	843	2.042
Total	184.567	20.216	2.131	2.756	209.670

Në vitin 2023, janë anketuar rreth 11.97 % e ndërmarrjeve nga 209.670 ndërmarrje të regjistruara në vitin 2022. Janë intervistuar të paktën një herë gjatë vitit 2023, 25,103 ndërmarrje, ndërsa 80.53 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak vrojtime dhe 19.47 % e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 vrojtime pranë ndërmarrjeve të realizuar nga INSTAT gjatë vitit 2023.

Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2019-2023, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimet pranë ndërmarrjeve ekonomike, që realizon INSTAT.

Tabela 3: Krahasoni 2019-2023

	2019	%	2020	%	2021	%	2022	%	2023	%
0 pyetësorë	142.257	87,50	139.289	85,80	143.377	86,20	155.589	85,70	184.567	88,03
të paktën 1 pyetësor	20.370	12,50	23.053	14,20	23.009	13,82	25.960	14,30	25.103	11,97


Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin “Numrin e pyetësorëve që INSTAT i dërgon ndërmarrjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet në seri me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Gjatë vitit 2023, INSTAT ka realizuar 15 vrojtime pranë ndërmarrjeve, njësoj sa vitin e kaluar dhe numri i ndërmarrjeve që kanë marrë të paktën një anketë rezultojnë të jetë afërsisht i njëjtë. Diferenca në përqindje e këtij numri lidhet më shumë me rritjen e numrit të ndërmarrjeve në regjistrë.

Tabela 4: Shpërndarje e ngarkesës në përqindje për çdo grup-madhësie të ndërmarrjes (%)

Grup_Size	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11 + pyetësorë	Total
1_9 të punësuar	91,32	7,93	0,16	0,58	100,00
10_19 të punësuar	10,64	67,08	14,07	8,21	100,00
20_49 të punësuar	17,42	42,84	26,01	13,72	100,00
50 + punësuar	25,02	10,82	22,87	41,28	100,00
Total	88,03	9,64	1,02	1,31	100,00

Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është i përqendruar numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre rreth 91.32 %, nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 7.93 % ngarkohen për të plotësuar 1 deri në 5 pyetësorë dhe 0.74 % e tyre ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga grafiku, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 86.28 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 10 pyetësorë për t'u përgjigjur dhe vetëm 13.72% e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart, ku rreth 74.98 % e tyre duhet t'i përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Figura 1. Shpërndarje e ngarkesës në përqindje për çdo grup-madhësie të ndërmarrjes



Anketat pranë familjeve 2023

Të gjitha anketat pranë familjeve të realizuara nga INSTAT përgjatë vitit 2023 kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2023, janë anketuar rreth 7,08 % Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Cens. Janë intervistuar gjithsej 51.133 NJEF, nga të cilat 73,59 % (37.628) e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 26,41 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime pranë familjes të realizuara nga INSTAT gjatë vitit 2023. Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve për vitin 2023, duke marrë në konsideratë të gjitha vrojtimitet pranë familjeve që realizon INSTAT:

Tabela 5: Vrojtmet pranë familjeve

Kodi_Qark	Emër_Qarku	0 pyetësorë	1 pyetësorë	2+ pyetësorë	Total Familje
01	BERAT	35.777	2.006	710	38.493
02	DIBËR	27.363	1.555	655	29.573
03	DURRËS	61.741	3.611	1.298	66.650
04	ELBASAN	67.776	3.823	1.445	73.044
05	FIER	75.926	4.654	1.494	82.074
06	GJIROKASTËR	19.524	1.239	524	21.287
07	KORÇË	55.799	3.186	1.186	60.171
08	KUKËS	15.623	1.052	451	17.126
09	LEZHË	29.759	1.705	772	32.236
10	SHKODËR	50.289	2.986	1.154	54.429
11	TIRANË	184.158	9.264	2.796	196.218
12	VLORE	47.394	2.547	1.020	50.961
	Total	671.129	37.628	13.505	722.262

Gjatë vitit 2023, në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 12.060 NJEF ose 6,15 % e tyre. Rreth 93,85 % e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë vrojtim, 4,72 % e tyre kanë marrë pjesë në 1 vrojtim dhe vetëm 1,43 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime të realizuara nga INSTAT.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2016-2023, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtmet pranë njësive ekonomike familjare, që INSTAT realizon, jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 6: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve 2016-2023

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
të paktën 1 herë	40.804	46.940	59.702	81.870	51.302	54.489	51.295	51.133
0 pyetësorë	681.458	675.322	662.560	640.392	670.960	667.773	670.967	671.129
Total	722.262	722.262	722.262	722.262	722.262	722.262	722.262	722.262

Indikatori “Numri i pyetësorëve që INSTAT i dërgon familjeve për t’u përgjigjur” nuk mund të krahasohet në seri të gjatë kohore pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre.

Gjatë vitit 2023 në krahasimin me vitin 2022, INSTAT ka realizuar të njëjtat aktivitete statistikore pranë familjeve, të gjitha të planifikuara në planin e statistikave zyrtare dhe jo aktivitete të reja. Numri i familjeve që kanë marrë të paktën një pyetësor ka një rënie të papërfillshme.

Tabela 7: Pjesëmarrja e familjeve në vrojtime sipas numrit të pyetësorëve


Kodi_Qark	Emër_Qarku	0 pyetësorë (%)	1 pyetësorë (%)	2+ pyetësorë (%)	Total Familje
01	BERAT	92,94	5,21	1,84	38.493
02	DIBËR	92,53	5,26	2,21	29.573
03	DURRËS	92,63	5,42	1,95	66.650

04	ELBASAN	92,79	5,23	1,98	73.044
05	FIER	92,51	5,67	1,82	82.074
06	GJIROKASTËR	91,72	5,82	2,46	21.287
07	KORÇË	92,73	5,29	1,97	60.171
08	KUKËS	91,22	6,14	2,63	17.126
09	LEZHË	92,32	5,29	2,39	32.236
10	SHKODËR	92,39	5,49	2,12	54.429
11	TIRANË	93,85	4,72	1,43	196.218
12	VLORË	93,00	5,00	2,00	50.961
	Total	92,92	5,21	1,87	722.262

Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t'i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit, si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.

Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta

Në lidhje me indikatorin e dytë kohëzgjatjen mesatare të intervistës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve për vitin 2023, të dhënat jepen në figurën e mëposhtme.



i
atja e intervistës mesatare në minuta /Pyetësorë

Kohëzgjatja e intervistës gjatë vitit 2023 për anketat pranë familjeve është mesatarisht rreth 33.4 minuta, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2022, ku kjo vlerë ishte 33.2 minuta. Ndërsa për intervistat pranë ndërmarrjeve kohëzgjatja e intervistës për vitin 2023 është 29.1 minuta, një rritje e lehtë krahasuar me vitin 2022, ku kohëzgjatja ishte 28.8 minuta.

INSTAT, për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarve, punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe trajnimin e anketueseve.

Planet e vazhdimësisë së Aktiviteteve Statistikore

Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 gjatë viteve 2020-2021 pati një ndikim të rëndësishëm si në aspektet e jetës ashtu edhe në mbarëvajtjen e punës në institucion. Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia, INSTAT-i u përqendrua maksimalisht për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e produkteve statistikore. Deri më tani janë hartuar dhe aprovuar planet e vazhdimësisë për 73 aktivitete statistikore.

Sistemi online për aksesimin nga jashtë të të dhënave mikro (SIMONA)

Sistemi “SIMONA” i është vënë në dispozicion të kërkuesve shkencorë që prej vitit 2020 dhe mundëson aksesimin e informacionit statistikor në distancë. Ky sistem mundëson aksesin e të dhënave mikro në interes të proceseve kërkimore-shkencore nga të gjithë përdoruesit brenda dhe jashtë vendit, si edhe të stafit të INSTAT.

Nëpërmjet sistemit SIMONA, gjatë vitit 2023, kanë patur akses 4 projekte dhe 4 përdorues, ndërsa gjatë vitit 2022 kanë patur akses 4 projekte dhe 6 përdorues.

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të Statistikave

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të Statistikave që prodhon INSTAT-i është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre, aty ku është e mundur, në procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Anketa është realizuar mbi të dhënat e përdoruesve që kanë kërkuar statistika pranë INSTAT duke u kombinuar edhe me pyetësorin online. Kampioni përbëhej nga përdoruesit që kanë kërkuar të dhëna statistikore në periudhën nga fillimi i vitit 2009 deri në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023. Pyetësi u dërgua me e-mail tek 2800 përdorues. Linqet për plotësimin e pyetësorit u vendosën në faqen zyrtare të INSTAT, si dhe në faqen zyrtare të Facebook, në mënyrë që çdo përdorues i interesuar të mund të merrte pjesë në këtë anketë.


Në Nëntor 2023, INSTAT-i zhvilloi raundin e shtatë të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve në vitin 2023 arriti vlerën 4.02 pikë nga 5 pikë të plota, duke shënuar një rritje me 1.74 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, ku kjo vlerë ishte 3.93 pikë. Rritje kanë pësuar gjithashtu dhe treguesit si: Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet, Kënaqësia me të dhënat, Kënaqësia me punonjësit e INSTAT, Besimi në të dhënat e INSTAT. Treguesi mbi kënaqësinë me faqen e internetit mbetet në të njëjtin nivel si një vit më parë. Tabela më poshtë paraqet vlerat e këtyre treguesve për vitet 2022-2023:

Tabela 8: Treguesit kryesorë të Anketës së Matjes së Kënaqësisë së Përdoruesve

Treguesi	2022	2023	Trendi
Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet	4.07	4.18	↑
Kënaqësia me të dhënat	3.78	3.89	↑
Kënaqësia me punonjësit e INSTAT	3.89	4.01	↑
Kënaqësia me faqen e internetit	3.97	3.97	→
Besimi - INSTAT ka të dhëna të besueshme	3.94	4.04	↑

Grafiku i mëposhtëm paraqet progresin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve përgjatë 5 viteve të fundit 2019-2023.

Figura 3: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve sipas viteve 2019-2023



Metodologjia e Vrojtimeve

Metodologjia e vrojtimeve përfshin disa procese kryesore, si përzgjedhjen e kampionit, përgjithësimin e rezultateve statistikore dhe vlerësimin e gabimeve për treguesit kryesorë. Këto procese janë thelbësore për të siguruar që të dhënat e grumbulluara janë të sakta dhe për të minimizuar gabimet.

Gjatë vitit 2023, INSTAT ka ndërmarrë disa nisma në kuadër të përmirësimeve metodologjike për disa aktivitete statistikore. Në anketat ekonomike është shtuar përdorimi i të dhënave si në një kampionim më eficient ashtu edhe në përpunimin e të dhënave. Në Anketën Strukturore pranë Ndërmarrjeve janë detajuar degë në stratifikim, duke rritur kështu përfaqësimin në to. Lidhur me Anketën e Prodhimeve Industriale janë rishikuar seritë kohore për vitet 2021-2022, si edhe është rritur niveli i përfaqësimit nga 2 shifror në 4 shifror. Për vërtetimin Vjetor në Bujqësi është rishikuar seria kohore e të dhënave për vitet 2018-2023.

VI. Teknologjia e Informacionit

Përdorimi i teknologjisë së Informacionit është i rëndësishëm për të përmirësuar proceset e prodhimit statistikor. Gjithashtu ndihmon në integrimin e burimeve të ndryshme të të dhënave dhe në përmirësimin e përpunimit të tyre. Në të njëjtën kohë, teknologjia ndihmon në lehtësimin e qasjes në statistikën zyrtare për përdoruesit dhe kërkuesit shkencorë.

Gjatë vitit 2023 INSTAT ka punuar për menaxhimin e infrastrukturës teknologjike të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve statistikore (sistemi i email; aktiviteti i direktorit të INSTAT; sistemi fizik cluster; sistemi i Backup; sistemi i sigurisë Firewall; akses kontrolli; kamerat e sigurisë; sistemi i aksesit të sigurt të të dhënave mikro; faqet e web: internet dhe intranet; PX-web; pajisjet periferike).

Janë mirëmbajtur sistemet/aplikacionet për mbledhjen e monitorimin e të dhënave në terren si edhe për llogaritjen e statistikave zyrtare. Aplikacionet janë të ndërtuara në platforma të ndryshme si .Net, CSPro, LimeSurvey; me baza të dhënash në SQL Server.

Janë menaxhuar bazat e të dhënave dhe databaza statistikore PX-web. Janë arkivuar të dhënat fillestare dhe ato të përpunuara.

Në kuadër të bashkëpunimit me Eurostat, gjatë kësaj periudhe është përdorur platforma Edamis 4 për të transmetuar të dhënat. Metadatat transmetohen përmes Metadata Handler duke u fokusuar në rritjen e cilësisë dhe sasisë së meta të dhënave të dërguara përmes kësaj platforme. INSTAT ka vazhduar punën për harmonizimin e listave të kodeve në bazën e të dhënave statistikore bazuar në listat e kodeve të EUROSTAT (RAMON) të cilat janë të përshtatur me listat e kodeve kombëtare.

VII. Komunikimi dhe Publikimet

INSTAT-i ka ndërtuar një strategji të veçantë drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në rëndësinë e statistikave zyrtare.

Gjatë vitit 2023 ecuria e vlerave të treguesve matës të vizibilitetit është si vijon:

- **Publikimet:** Numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 171 Gjatë vitit 2023, nga 165 që ishte në vitin 2022.
- **Kërkesat e përdoruesve:** Sa i takon kërkesave të përdoruesve, duke iu referuar databazës së kërkesave të përdoruesve, e cila është krijuar për herë të parë në vitin 2009, numri i kërkesave për të dhëna statistikore ka ardhur në rritje. Në vitin 2023, numri i kërkesave të përdoruesve është 1007, dhe 14 kanë qenë kërkesa për mikrodata. Kjo vlerë është rritur me 191 kërkesa, krahasuar me vitin 2022, ku numri i kërkesave ishte 816.
- **Edukimi statistikor:** Në 2023 INSTAT, riorganizoi seksionin në Këndin i Edukimit Statistikor, në të cilin janë përmbledhur produkte statistikore të nevojshme për edukim statistikor të përdoruesve. Projekti “Statistika në shkollë” është krijuar për t’i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve dhe atyre që kanë interes për statistikat, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikat dhe disa nga konceptet themelore të saj. Gjatë vitit 2023 janë përditësuar temat e publikuara në seksionin e Edukimit Statistikor me video dhe infografikë. Këtij aktiviteti i shtohet dhe bashkëpunimi i ngushtë me hartuesit e politikave, si përdoruesit kryesorë të statistikave zyrtare. Revista Kërkimi dhe INFOSTAT, janë vlerë tjetër e shtuar, me pasurimin e dijeve jo vetëm me analiza shkencore, por edhe me informacione si prodhohen statistikat zyrtare. Platformat online me informacione
- **Rrjeti social facebook:** Pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave në facebook arritën në 8.150 gjatë vitit 2023 nga 6.436 që ishin në vitin 2022. Shikueshmëria në 2023 ishte 496.312 shikime duke e rritur kurbën e shikimeve gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2023 gjatë fushatës së rekrutimeve dhe fushatës masive të komunikimit.
- **Vizibiliteti në media:** Në vitin 2023 INSTAT ka publikuar 7 reagime/njoftime për mediat në Seksionin e Reagimeve në faqen zyrtare INSTAT, ndër të cilat 5 kanë që komunikime me mediat dhe publikun në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave.
Sa i takon vizibilitetit në media gjatë vitit 2023, përmendja dhe citimi i INSTAT dhe Drejtorit të Përgjithshëm është si më poshtë në artikuj dhe kronika të lidhura me aktivitetin e INSTAT, si dhe procesin e Censit të Popullsisë dhe Banesave:

INSTAT

- 2.913 herë në përmbajtjen e 1.585 artikujve të botuar në shtypin shqiptar;
- 42 herë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme;
- 1.231 herë në përmbajtjen e 1.082 kronikave në lajmet kryesore të televizioneve më të ndjekura në Shqipëri;
- 22.569 herë në përmbajtjen e 11.396 artikujve të publikuara në portalet online.

Drejtori i Përgjithshëm Znj. Elsa Dhuli


- 25 herë në përmbajtjen e 20 artikujve të botuar në shtypin shqiptar;

- 3 herë në faqet e para të gazetave dhe revistave të përditshme;
 - 45 herë në përmbajtjen e 44 kronikave në lajmet kryesore të televizioneve më të ndjekura në Shqipëri
 - 197 herë në përmbajtjen e 169 artikujve të publikuara në portalet online
- **Statistikat e website:** Për vitin 2023 faqja web e INSTAT ka pasur 3.020.981 page views ⁴, krahasuar me 3.585.663 page views që ka patur në vitin 2022, duke u ulur me 564.682 page views.

Publikimet

Gjatë vitit 2023, numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 171, nga 165 që ishte në vitin 2022 dhe janë përgatitur vizualisht 12 publikime libër në të cilën kanë paraqitur treguesit kryesor që INSTAT publikon.

Figura 4: Numri i publikimeve përgjatë viteve 2017-2023



Librat

Vjetari Statistikor Rajonal

Treguesit rajonalë ofrojnë krahasime të treguesve statistikorë më të rëndësishëm të vendit në nivel rajoni/qarku/bashkie. Zakonisht rajonet janë të krahasueshme ndërmjet tyre nga pikëpamja statistikore, por në realitet është vështirë të krahasohet një rajon i vogël me një rajon të madh për nga popullsia. Vjetari Statistikor Rajonal synon të sigurojë një perceptim më të gjerë të statistikave që janë grumbulluar në nivel qarku nga subjektet nëpërmjet vrojtimeve statistikore apo burimeve administrative. Nëpërmjet këtij botimi jepet informacion i vlefshëm statistikor, i cili shërben për krahasimin e treguesve ekonomikë, social, mjedisor, ndërmjet rajoneve, etj.

Regjistrat e Biznesit

Statistikat zyrtare bazuar në regjistrat e biznesit i shërbejnë gjithë komunitetit të biznesit, politikë-bërësve, dhe akademikëve për të analizuar situatën ekonomike në vend. Gjithashtu këto statistika shërbejnë për të ndërmarrë iniciativa dhe vendime të drejta për të përmirësuar klimën dhe zhvillimin e bizneseve.

Shqipëria në Shifra

Shqipëria në Shifra paraqet në mënyrë sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Botimi përmban 36 kapituj: Demografia, Shëndetësia, Kushtet Sociale, Arsimi, Kultura, Papunësia, Punësimi, Çmimet, Tregtia e Jashtme, Transporti, Turizmi, Llogaritë Kombëtare, Regjistri i Ndërmarrjeve, Inovacioni etj.

Burra dhe Gra në Shqipëri

Publikimi “Burra dhe Gra në Shqipëri” është një publikim me periodicitet vjetor, i cili paraqet të dhëna për fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë dhe paraqet matjen dhe monitorimin e jetës së grave dhe

⁴ Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

burime në shoqëri. Kapitujt e përfshirë në këtë botim pasqyrojnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore të cilat janë përpunuar dhe vendosur në kontekst nga stafi i INSTAT, duke i bërë ato më të lehta dhe të kuptueshme për publikun e gjerë.

Tregtia e Jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet

Botimi pasqyron disa nga kërkesat themelore dhe nevojat e disa grupeve të përdoruesve për të dhënat mbi tregtinë e mallrave dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare. Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend, përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri.

Ndërmarrjet e huaja dhe të përbashkëta

Statistikat në lidhje me ndërmarrjet private të huaja dhe të përbashkëta (shqiptare dhe të huaja) synojnë të tregojnë strukturën, masin treguesit ekonomikë, format e organizimit, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. INSTAT, nëpërmjet këtij publikimi plotëson disa prej kërkesave për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor, akademikëve, etj, të cilat janë vazhdimisht në rritje.

Transporti në shifra

Transporti është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë dhe luan një rol jetik në shoqërinë e sotme të lëvizshme. Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave situatën reale në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative të treguesve statistikorë lidhur me transportin hekurudhor, rrugor, detar dhe ajror lidhur me sasinë e mallrave dhe numrin e pasagjerëve që lëvizin çdo vit, mjetet e përdorura, si dhe treguesit e sigurisë në transport.

Tregu i Punës

Botimi mbi Tregun e Punës është një burim i rëndësishëm informacioni mbi situatën dhe tendencat e tregjeve kombëtare të punës. Ai ndihmon për të monitoruar politikat dhe strategjitë kryesore për punësimin dhe pagat, sipas gjinisë dhe strukturës gjinore dhe moshore, shkallës arsimore, aktivitetit ekonomik dhe profesioneve. Botimi i dedikuar Tregut të Punës përmban një analizë të zgjeruar të publikimeve tremujore bazuar në burime administrative dhe Anketën e Forcave të Punës.

Turizmi në Shifra

Ky publikim i dedikuar paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative dhe dy anketa: Anketa “Pushime dhe Udhëtime” dhe “Anketa e Strukturave Akomoduese”.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Publikimi “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2022” përmban 9 kapituj dhe 2 anekse ku fillon me mesazhet kyçe deri te rekomandimet për përgatitjen e raporteve vullnetare si dhe raste studimore dhe iniciativa të ndryshme nga e gjithë bota në lidhje me ecurinë e OZHQ-ve. INSTAT së bashku me Ministrinë e Linjës dhe disa institucione të tjera është pjesë e grupit teknik ndër-institucional të punës për punën e OZHQ-të, drejtuar nga Kryeministria.

Statistika të Kulturës

INSTAT publikon statistika në kulturë, duke u përqëndruar në pjesëmarrjen kulturore dhe në dimensionin ekonomik të kulturës. Treguesit e paraqitur lidhen me pjesëmarrjen dhe trashëgiminë kulturore, edukimin dhe punësimin në kulturë. Gjithashtu, seksione të veçanta i dedikohen edhe përdorimit të internetit për qëllime kulturore, dhe shpenzimeve publike në kulturë.




Kërkesat e përdoruesve

INSTAT regjistron çdo kërkesë të përdoruesve për informacion statistikor në databazën e përdoruesve dhe nëpërmjet saj INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, nga krijimi në vitin 2009, mund të themi që

kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme, ku në vitin 2023 numri i kërkesave të përdoruesve është 1007.

Figura 5: Numri i kërkesave të përdoruesve 2016 – 2023



Duke e thelluar analizën e statistikave lidhur me plotësimin e kërkesave të përdoruesve, vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve në vitin 2023 është rritur me 191 kërkesa, duke u shënuar 1007 kërkesa, nga 816 kërkesa që ishin në vitin 2022. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave, mund të themi se numrin më të madh të kërkesave të plotësuara në vitin 2023 e zënë statistikave të çmimeve me 365 kërkesa, pasuar nga statistikave sociale për popullsinë me 201 kërkesa, si dhe statistikave të turizmit, transportit dhe aksidenteve me 99 kërkesa, etj. Një pasqyrë e hollësishme e numrit të kërkesave sipas temave statistikore paraqitet në figurën dhe tabelën e mëposhtme:

Figura 6: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas temave specifike statistikore




Tabela 9: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas temave specifike statistikore

Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave 2022	Numri i kërkesave 2023
Çmimet	344	365
Bujqësia dhe Blegtoria	19	14
Tregtia e jashme	58	50
Anketa e Strukturës së Ndërmarrjeve	29	8
Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve	23	30
Llogaritë kombëtare	19	21
Popullsia/lindjet-vdekjet/martestat/divorcet/emigracioni	97	201
Ndërtimi	3	5
Shkaqet e vdekjeve /shëndetësia	11	32
Punësimi/papunësia/pagat	52	79
Turizmi/transporti/aksidentet	71	99
Konsumi i familjeve /niveli jetesës / shpenzimet e familjes	44	40
Të tjera/të ndryshme/Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore	38	63
Pyetësor të ndryshëm		
Mikrodata	5	14
Totali	816	1.021

Edukimi statistikor

Projekti “Statistika në shkollë” është krijuar për t’i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve, si dhe atyre që kanë interes për statistikat, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikat dhe disa nga konceptet themelore të saj. Gjatë vitit 2023, janë përditësuar të gjitha temat e publikuara në seksionin e Edukimit Statistikor me video dhe infografikë.

Edukimi statistikor është njohja e publikut të gjerë me informacione dhe njohuri statistikore, të cilat nevojiten për të kuptuar apo për të qenë në gjendje të gjykojmë nëse një njoftim, një shifër, një çmim apo një reklamë është e arsyeshme apo jo.

Qëllimi i edukimit statistikor është forcimi i sistemit statistikor dhe statistikave zyrtare përmes literaturës statistikore për përdoruesit e rinj dhe joekspertë të statistikave. Nëpërmjet edukimit statistikor, synohet ndërgjegjësimi i të rinjve për rëndësinë e statistikave zyrtare dhe përdorimin e tyre. Në kuadër të këtij projekti INSTAT ka përgatitur dhe publikuar disa artikuj statistikorë, të trajtuar në mënyrë të tillë që të nxisin interes për të rinjtë dhe personat e interesuar që të mësojnë rreth statistikave.

Temat janë si më poshtë:

- Popullsia e Shqipërisë
- Shpenzimet e konsumit në Shqipëri
- Piramida e popullsisë
- Çmimet e konsumit në Shqipëri
- Arsimi në Shqipëri
- Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri
- Prodhimi i Brendshëm Bruto
- Regjistri i ndërmarrjeve në Shqipëri
- Statistikat e tregut të punës

- Punësimi në Shqipëri
- Papunësia në Shqipëri

Rrjeti Social Facebook dhe INSTAGRAM

Gjatë vitit 2023, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave në facebook arritën në 8.150 nga 6.436 në 2022. Shikueshmëria në vitin 2023 ishte 496.312 shikime, duke e rritur kurbën e shikimeve gjatë periudhës Maj-Dhjetor 2023 gjatë fushatës së rekrutimeve dhe fushatës masive të komunikimit.

Figura 7: Shikueshmëria, 2023 - Facebook





Figura 8: Shikueshmëria 2023 - INSTAGRAM



Statistikat e Website të INSTAT

Për vitin 2023 faqja web e INSTAT ka pasur 3.020.981 page views ⁵, krahasuar me 3.585.663 page views që ka patur në vitin 2022, duke u ulur me 564.682 page views. Megjithatë, numri i klikimeve për temat kryesore statistikore, krahasuar me një vit më parë, ka pësuar një rritje prej 406,660 klikime ose 23,4 %. Në tabelën më poshtë paraqiten të renditura temat dhe numri i shikimeve përkatëse gjatë harkut kohor 2018-2023.

⁵ Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

Tabela 10: Page views sipas temave kryesore 2018 -2022

Tema	Total 2018	Total 2019	Total 2020	Total 2021	Total 2022	Total 2023
Shkencë Teknologji dhe Shoqëria Digjitale	5.189	7.548	8.166	12.054	13.241	13.787
Çmimet	41.263	31.879	91.016	139.969	143.578	151.100
Bujqësia dhe Peshkimi	18.800	26.622	25.849	26.342	44.614	31.301
Statistikat e Përgjithshme dhe	13.961	16.399	16.907	14.539	26.799	21.543
Tregtia e Jashtme	17.891	22.508	46.558	59.687	63.657	65.753
Kushtet Sociale	25.463	42.049	48.659	58.986	64.302	56.543
Tregu i Punës dhe Arsimi	61.446	114.113	130.851	221.354	256.488	264.876
Censet	14.936	19.050	18.390	28.872	44.039	123.543
Mjedisi dhe Energjia	11.921	14.725	15.138	16.293	26.168	15.876
Industria Tregtia dhe Shërbimet	68.291	74.284	91.851	123.454	234.011	153.428
Ekonomi dhe Financë	79.014	83.394	72.279	72.151	128.756	98.765
Treguesit Demografikë dhe	100.697	133.713	195.443	179.592	314.300	402.907
Gjithsej	458,872	586,284	761,107	953,293	1.359.953	3.020.981

Programi i transparencës

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur Programi i Transparencës për Institutin e Statistikave. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit. Programi vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës INSTAT-i ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

INSTAT-i përditëson herë pas here Programin e Transparencës. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparente veprimtarinë e punës së INSTAT-it, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.instat.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e publikimit, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të Programit të Transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Faqja zyrtare elektronike e INSTAT-it është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

Parime të Përgjithshme

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së INSTAT-it janë:

- “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

- -Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: INSTAT-i ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- -Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e INSTAT-it dhe përkatësisht: Ligji nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për zbatimin e tij.
- -Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
- -Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- -Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

-Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

Në aneksin numër 2 paraqitet një informacion i shkurtër dhe kolazh me foto nga fushata e komunikimit në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

VIII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

INSTAT vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë zbatimit të Agjendës 2030 për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi statistikën janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikën dhe strategjitë që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për të siguruar një vendimmarrje të bazuar në evidenca.

Aktualisht INSTAT prodhon 66 indikatorë statistikorë, të cilët përditësohen në platformën për OZHQ-të, në faqen zyrtare të INSTAT <http://www.instat.gov.al/al/sdgs/> dhe INSTAT punoi për botimin e radhës në të dy gjuhët, i cili do të ketë një paraqitje vizuale me infografikë. Viti 2024, do ketë dhe prodhimin e numrit më të lartë të indikatorëve bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave.


Gjithashtu INSTAT gjatë vitit 2024, do të zbatojë një projekt statistikor për OZHQ-në, pjesë e Programit Shumëpërfitues IPA 2022, i cili do të ketë në fokus përmirësimin e dashbordit për OZHQ-të, paraqitjen në mënyrë sa më të kuptueshme dhe pranë përdoruesit të indikatorëve si dhe komunikimin e tyre.

IX. Organigrama dhe baza ligjore

Struktura e Institutit të Statistikave

Në fund të vitit 2023, gjendja faktike në INSTAT është 225 punonjës nga 236 pozicione të organikës, nga të cilët 213 punonjës në shërbimin civil, 12 punonjës administrative dhe 11 pozicione vakante. Në figurën e mëposhtme paraqitet organigrama në fuqi e INSTAT.

Figura 9: Organigrama e Institutit të Statistikave



Kuadri Rregullator për fushën e prodhimit të statistikave zyrtare

Veprimtaria e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-it, si pjesë kryesore përbërëse e tij, ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 “Për statistikatat zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2022-2026 miratuar me Ligjin Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”. Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet edhe në normat ligjore, të cilat rregullojnë veprimtarinë sektoriale të prodhuesve të tjerë të statistikave zyrtare, çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale etj.

Në kuadrin rregullator të Sistemit përfshihen edhe konventat e marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare në interes të zhvillimit statistikor në vend, si dhe aktet komunitare të BE-së në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përarrfrojë standardet statistikore të përcaktuara veçanërisht në Rregulloren (KE) nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 11 Mars, 2009, “Mbi statistikatat evropiane”, ndryshuar me rregulloren (KE) të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill, 2015.

Instrumentë të tjerë rregullatorë të veprimtarisë statistikore të SKS janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit, të nënshkruara nga INSTAT me institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative, si edhe institucionet që mbështesin kryerjen e aktiviteteve.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu pjesë e kornizës ligjore që siguron harmonizimin e emërtimeve dhe kodifikimeve të produkteve, mallrave e shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, dhe për rrjedhojë, edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore, në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

a) Ligji nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare” u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë në lidhje me forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe rritjen e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave zyrtare. Miratimi i ligjit u cilësua nga partnerët ndërkombëtarë si hapi më i rëndësishëm në fushën e prodhimit statistikor për të garantuar cilësinë statistikore dhe përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për këto produkte. Me pozicionimin e INSTAT-it si institucion publik i pavarur, i cili raporton drejtpërdrejt në Kuvend, është mundësuar rritja e besueshmërisë së publikut në vlefshmërinë e statistikave të prodhuara, si dhe bashkëpunimi profesional ndërmjet aktorëve të tjerë të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në zbatim të ligjit për statistikatat zyrtare, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë miratuar akte nënligjore, të cilat rregullojnë më tej funksionimin e sistemit statistikor dhe organeve të përfshira në drejtimin e tij:

- i. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidaturave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”. Ky akt është hartuar në vijim të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT. Ai përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që duhen ndjekur për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, duke ndjekur procedurën transparente dhe publike të përzgjedhjes së tij.
- ii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërbërimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Vendimi është nxjerrë si pasojë e ndryshimit të natyrës së përfaqësimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Sipas kërkesave të ligjit, Këshilli i Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grupi i drejtpërdrejtë i interesuar për produktin statistikor. Në përbërje të tij janë përfshirë anëtarë

përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organet e vetëqeverisjes vendore, medias, botës akademike, shoqërisë civile, Bankës së Shqipërisë, ministrisë përgjegjëse për financën, Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

- iii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 07.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën është organ i cili udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të cilat përpunojnë të dhëna administrative. Ky komision ka për detyrë të kryejë përditësimin, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare. Harmonizimi i nomenklaturës finalizohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të këtij komisioni.
- iv. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.06.2019 “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara”. Ky vendim është miratuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit për statistikën zyrtare, në vijim të rritjes së autonomisë së INSTAT-it në menaxhimin e të ardhurave që krijon gjatë shërbimeve statistikore të kryera përtej atyre të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij.
- v. Vendimi i Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave”. Për shkak të ligjit të ri për statistikën zyrtare, INSTAT ka ndryshuar statusin nga institucion qendror në varësi të ekzekutivit, në institucion publik të pavarur. Struktura organizative e institucioneve të pavarura rregullohet me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar.
- vi. Vendimet e Kuvendit nr. 75/2019, 76/2019, 77/2019, 78/2019, 79/2019, 80/2019 dhe 81/2019, datë 04.07.2019, 61/2021 datë 01.07.2021 dhe 32/2023, 33/2023, 34/2023, 35/2023 datë 25.05.2023 për lirimim/emërimin/zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Vendimet e Kuvendit mundësuan plotësimin e të gjitha vendeve vakante të Këshillit të Statistikave dhe funksionimin e plotë të tij. Referuar ligjit për statistikën zyrtare, anëtarët e Këshillit gëzojnë mandat 5-vjeçar me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

b) Programi i Statistikave Zyrtare

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, për një hark kohor prej pesë vitesh. Programi është dokumenti kryesor mbi të cilin bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare. Ai përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Programi respekton garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në legjislacionin për statistikën zyrtare, në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane⁶ dhe Parimet Themelore të Kombeve të Bashkuara (Fundamental principles).

Programi aktual përfshin periudhën 2022-2026 dhe është miratuar me Ligjin Nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022–2026”.

⁶<http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

c) Memorandume Mirëkuptimi

Për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe për t'iu përshtatur standardeve të reja të përcaktuara nga ligji për statistikat zyrtare, INSTAT ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me një sërë institucionesh furnizuese me të dhëna administrative.

Gjatë vitit 2023 është nënshkruar një memorandum i ri mirëkuptimi që zëvendëson memorandumin e mëparshëm përkatësisht: ndërmjet INSTAT dhe MBZHR - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku palët kanë dakordësuar për shkëmbimin e të dhënave që disponojnë, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor dhe kuadrin ligjor mbi të cilin ushtrojnë veprimtarinë institucionet përkatëse. Ndër të tjera, palët shprehin vullnetin për të zhvilluar aktivitete e projekte të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, përfshirjes së stafit në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit statistikor, etj.


Gjithashtu, janë firmosur katër marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet INSTAT dhe Fakulteti të Gjuhëve të Huaja, ndërmjet INSTAT dhe Universitetit Polis, ndërmjet INSTAT dhe Këshillit të Investimeve, ndërmjet INSTAT dhe Statistical Economic and Social Research and Training Center for Islamic Countries. Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara kanë për qëllim përfshirjen e kërkuesve shkencorë në proceset e prodhimit dhe përdorimit të statistikave zyrtare si dhe të studentëve për tu njohur me fushën statistikore si praktikantë. Për të siguruar zbatimin e duhur të marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, të cilët jo vetëm do të kujdesen për zbatimin e saj, por edhe për të propozuar ide apo veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore.

Bazuar në aktivitetet e Planit Operacional, synohet që për vitin 2024 të rishikohen memorandumet ekzistuese, aty ku do shikohet e nevojshme, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional. Memorandumet e reja që priten të nënshkruhen në vitin 2024 janë me institucionet si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave

Grafiku më poshtë paraqet situatën aktuale të MB, si dhe memorandumet që priten të nënshkruhen gjatë vitit 2024.

Figura 10. Situata aktuale e Memorandumeve/Marrëveshjeve të bashkëpunimit



Lista e memorandumeve të mirëkuptimit dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është paraqitur në aneksin nr. 3 të këtij dokumenti.

X. Veprimtaria e organizmave mbështetës të prodhimit statistikor

Referuar legjislacionit për statistikat zyrtare, organizmat mbështetëse për prodhimin statistikor janë:

- Bordi Drejtues i INSTAT-it
- Këshilli i Statistikave
- Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën

Veprimtaria e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues është organ i cili vepron brenda INSTAT-it dhe ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij, si dhe t'i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT udhëzime e standarde, të cilat sigurojnë zbatimin e parimeve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Detyrat specifike të bordit përcaktohen në nenin 20 të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare".

Bordi Drejtues përbëhet nga nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit. Në interes të transparencës me publikun, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Peer Review 2018, veprimtaria e Bordit Drejtues është publikuar në faqen zyrtare të internetit të INSTAT-it.

Gjatë vitit 2023, Bordi Drejtues ka zhvilluar 8 mbledhje, përkatësisht në datat: 12.01.2023; 02.06.2023; 26.07.2023; 15.09.2023; 16.11.2023; 11.12.2023; 19.12.2023; 22.12.2023.

Në katërmujorin e parë të vitit Bordi Drejtues zhvilloi 1 mbledhje në datë 12.01.2023, ku pas shqyrtimit dhe diskutimeve u miratua Plani i Rekrutimeve 2023. Dokument i cili përmban numrin e vendeve vakante, pozicionet vakante dhe grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

Në katërmujorin e dytë Bordi zhvilloi 2 mbledhje përkatësisht në datat 02.06.2023 dhe 26.07.2023. Në mbledhjen e parë u shqyrtua raporti i paraqitur nga Njësia e Burimeve Njerëzore mbi zbatimin e planit të trajnimeve dhe planit të rekrutimeve. Në drejtim të trajnimeve diskutimet u fokusuan në produktivitetin e realizimit të trajnimeve, si dhe në priorizimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve të stafit. Në pikën e dytë të agjendës u miratuan vendet vakante të hapura rishtazi. Në mbledhjen e dytë, të datës 25.07.2023 u miratua hapja e vendeve vakante të krijuara rishtazi.

Në katërmujorin e tretë u zhvilluan 5 mbledhje. Në mbledhjen e parë të këtij katërmujori, datë 15.09.2023, u miratua hapja e vendeve vakante të krijuara rishtazi. Në mbledhjen pasardhëse të datës 16.11.2023 Bordi shqyrtoi Planin Vjetor 2024 për zbatimin e PSZ 2022-2026. Ky dokument u paraqit në Bord pas diskutimit në Këshillin e Statistikave. Bordi shqyrtoi rekomandimet e Këshillit mbi dokumentin, si dhe sugjeroi ndryshimet e mundshme në seksione të ndryshme të projekt-planit. Pas diskutimit dhe reflektimit të propozimeve Bordi miratoi Projekt-Planin 2024 për zbatimin e PSZ 2022-2026. Në 3 mbledhjet e fundit të këtij katërmujori përkatësisht në datat 11.12.2023, 19.12.2023 dhe 22.12.2023 në fokus të diskutimeve ishin propozimet për rishikimin e strukturës organizative të INSTAT. Pas marrjes dhe shqyrtimit të propozimeve Bordi Drejtues në mbledhjen e datës 22.12.2023 miratoi propozimin për strukturën e re organizative të INSTAT.

Veprimtaria e Këshillit të Statistikave

Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se Programi Statistikave Zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikën zyrtare.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit e statistikave zyrtare, botën akademike, shoqërinë civile, sipërmarrësit privatë, organet e vetëqeverisjes vendore dhe median.

Emërimi i anëtarëve bëhet me vendim të Kuvendit. Këshilli i Statistikave e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” dhe VKM-në nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

Këshilli i Statistikave mbledhet të paktën tri herë në një vit kalendarik. Kuorumi përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të Këshillit. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 2 mbledhje të Këshillit, përkatësisht në datat 03.07.2023 dhe 23.10.2023.

Në mbledhjen e parë të Këshillit, datë 03.07.2023, anëtarët e rinj u njohën me veprimtarinë dhe rregulloren e Këshillit të statistikave. Pikë e axhendës së kësaj mbledhje ishte dhe zgjedhja e kryetarit dhe nënkryetarit të Këshillit të Statistikave, të cilët u zgjodhën me unanimitet të plotë. Në zbatim të pikës së tretë të axhendës Drejtori i Përgjithshëm prezantoi ecurinë e zbatimit të PSZ gjatë periudhës Janar-Prill, 2023. Prezantimi u hap me paqartësinë e ecurisë së zbatimit të objektivave strategjik të SKS për periudhën referencë dhe vijoi me një pasqyrim të përgjithshëm të ecurisë së fazës së grumbullimit, përpunimit, publikimit dhe transmetimit të të dhënave. Drejtori i Përgjithshëm vijoi gjithashtu me një informacion mbi aktivitetet kryesore të realizuara në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave, si dhe aktivitetet përgatitore për Censin e Bujqësisë. Pas diskutimeve Këshilli miratoi Raportin 4 muor mbi zbatimin e PSZ për periudhën Janar-Prill, 2023.

Në mbledhjen e dytë të Këshillit të Statistikave, të mbajtur më datë 23.10.2023 u shqyrtua Projekt-Plani Vjetor 2024 për zbatimin e PSZ 2022-2026, si dhe raporti 4 muor mbi zbatimin e PSZ për periudhën Maj-Gusht, 2023. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT prezantoi në mënyrë të përmbledhur informacionin mbi seksionet kryesore përmbajtëse të dokumentit, duke u fokusuar tek risitë dhe prioritetet e prodhimit statistikor gjatë vitit 2024, duke u theksuar si risi zgjerimi i SKS, ku me miratimin e Projekt-Planit në Kuvend Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore merr statusin ‘Agjenci Statistikore’, përgjegjëse për prodhimin dhe publikimin e statistikave të bilancit energjitik me frekuencë tremujore dhe bilancit energjitik me frekuencë vjetore. Në mënyrë më të detajuar u prezantuan dhe parashikimet për vitin 2024 lidhur me aktivitetet në kuadër të aktiviteteve madhore statistikore siç është Censi i Popullsisë dhe Banesave dhe Censi i Bujqësisë. Në vijim të diskutimeve mbi dokumentin Këshilli rekomandoi që treguesit mbi Standardet e Shpërdarjes së Statistikave (SDDS) të jenë pjesë e Planit Vjetor. Pika e dytë e agjendës iu dedikua shqyrtimit të raportit 4-muor mbi zbatimin e PSZ për periudhën Janar-Prill, 2023, ku Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT paraqiti në mënyrë të përgjithshme ecurinë e zbatimit të PSZ për këtë periudhë fokusuar në zbatimin e afateve për realizimin e fazave të prodhimit statistikor për produktet statistikore të planifikuara në këtë periudhë. Pjesë e prezantimit ishte dhe seksioni dedikuar aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe aktiviteteve të Censit të Bujqësisë të realizuara gjatë periudhës Maj-Gusht, 2023.

Veprimtaria e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën drejton aktivitetet për përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike dhe sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare.

Komisioni e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe akteve nënligjore që rregullojnë ngritjen, funksionimin, detyrat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni.

KKN kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, dhe anëtarët e komisionit përfaqësojnë institucionet sipas VKM Nr. 671, datë 07.11.2018.

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave përbëhet nga 19 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit kryesorë të nomenklaturave, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Nomenklaturat përdoren si bazë për mbledhjen, përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave në çdo fushë statistikore. Ato ofrojnë koncepte të standardizuara, të përdorura për të përshkruar fenomene të tilla si aktiviteti ekonomik, produktet, shpenzimet, profesioni, shëndetësia etj, si dhe shërbejnë për të matur në mënyrë të vazhdueshme këto fenomene brenda vendit dhe në të gjithë vendet dhe rajonet gjeografike. Klasifikimet ndërkombëtare vendosin standarde për klasifikimet e përdorura, të cilat shërbejnë si modele për zhvillimin e klasifikimeve statistikore përkatëse kombëtare. Nomenklaturat bëjnë të mundur krahasimin e të dhënave me rajonin, Evropën apo edhe me shtetet e tjera në mbarë botën. Ato janë mjete që përdoren nga organizatat kombëtare të statistikave, agjencitë ndërkombëtare, akademitë dhe përdoruesit e tjerë, përfshirë edhe përfaqësuesit ligjorë.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar dy mbledhje të Komisionit, përkatësisht në datat 20 Qershor 2023 dhe 27 Dhjetor 2023.

Në datë 20.06.2023 u zhvillua mbledhja e parë e KKN-së. Diskutimet u fokusuan në çështje si: Plani i aktiviteteve në vazhdim për 2023; Informim mbi rishikimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 2.1; Çështje të tjera, ku në fokus ishte prezantimi i aktivitetit të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Në datë 27.12.2023 u zhvillua mbledhja e radhës dhe e fundit për vitin 2023. Diskutimet u fokusuan në çështje si: Prezantimi i draft planit të aktiviteteve për vitin 2024; Informim mbi rishikimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev 2.1; Çështje të tjera, ku në fokus ishte prezantimi i ecursë së Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.


Gjithsej janë miratuar 11 akte ligjore në drejtim të klasifikimeve.

XI. Zbatimi i Rekomandimeve

Zbatimi i rekomandimeve të Kuvendit

Gjatë vitit 2023 ka vijuar përpjekja për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit. Nga situata aktuale e zbatimit të tyre rezulton që nga 8 rekomandime në total 4 rekomandime janë në proces, 2 rekomandim është realizuar dhe 2 rekomandime janë në zbatim të vazhdueshëm.

Figura 11: Ecuria e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit



Në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar ecuarja për çdo rekomandim dhe aktivitetet e ndërmarra nga INSTAT për përmbushjen e plotë të tyre:

Rekomandimi 1

Të zbatojë me cilësi dhe në kohë Censin e Popullsisë dhe Banesave, duke u bazuar në përcaktimin e qartë të vizionit dhe objektivave strategjike për kryerjen e censit, si dhe duke e konsideruar atë instrument kryesor për procesin e negociatave.

Statusi: Realizuar

Censi i Popullsisë dhe Banesave ka ndjekur "Rekomandimet për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020 të Konferencës së Statisticienëve Evropianë" hartuar në bashkëpunim të ngushtë me Eurostat dhe në përputhje me rishikimin e "Parimeve dhe Rekomandimeve për Censet e Popullsisë dhe Banesave" globale: raundi i vitit 2020". Referuar ligjit 140/2020, dita e Censit, Data 18 Shtator 2023 u miratua në seancën plenare të datës 26 Janar 2023, së bashku me Planin Vjetor 2023 të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT. Kohëzgjatja e Censit në terren ishte 18 Shtator - 30 Tetor 2023. Kryerja e Censit të Popullsisë dhe Banesave zbaton rekomandimin e Progres raportit 2022 për Kapitullin 18 "Statistikat".

INSTAT ka kryer një sërë procesesh përgatitore, sipas njësive përkatëse, si në Metodologji, Teknologji Informacioni dhe Cilësi, Gjeoinformacion, Komunikim, Logjistikë, Burime Njerëzore, Financa. Gjithashtu gjatë vitit 2023, INSTAT ka zbatuar fushatën e komunikimit për Censin, në bashkëpunim me kompaninë e rekrutuar për këtë qëllim dhe në përputhje me strategjinë e komunikimit. Për realizimin e këtij aktiviteti madhor, INSTAT ka kryer një sërë trajnimesh nga muajt Prill - Nëntor 2023 duke trajnuar 7014 persona.

Anketa Pas Cens u realizua gjatë periudhës 20 Nëntor-20 Dhjetor 2023 në 100 zona numërimi, në 12 qarqet e vendit. Kjo anketë ishte si një instrument për vlerësimin e Censit, qëllimi i së cilës është: vlerësimi i mbulimit të Censit dhe vlerësimi i cilësisë së numërimit.

Rekomandimi 2

T'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë së komunikimit për promovimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave, i cili është thelbësor për të siguruar ndërgjegjësimin statistikor, rritjen e besueshmërisë dhe pjesëmarrjen e popullatës në këtë proces, që do të bëjnë të mundur realizimin e Censit të Popullsisë dhe të Banesave brenda vitit 2022.

Statusi: Realizuar

Për realizimin e këtij rekomandimi, INSTAT ka zhvilluar dy fushata komunikimi dhe koordinimin me mediat. Fushata e parë ishte fushata e rekrutimit e cila u zhvillua nga data 15 Maj 2023 deri në 31 Korrik 2023, në të cilën nëpërmjet citylights dhe stendave informuese përçdo Bashki, INSTAT informoi qytetarët dhe opinionin publik për aktivitetin e Cens-it. Gjithashtu nëpërmjet kësaj fushate ftoi personat e interesuar të aplikonin dhe të bëheshin pjesë e stafit të terrenit.

Fushata e dytë u zhvillua në muajt Shtator – Tetor 2023 dhe kishte në fokus informimin masiv të popullatës për aktivitetin e Censit. Gjatë kësaj periudhe u bë informimi me të gjitha mjetet e komunikimit nëpërmjet: video spoteve në TV, spoteve në radio citylight billboards, ekranet ledrrjetet social dhe Cens on tour. Gjatë vitit 2023, në kuadër të Censit është bërë koordinimi i kërkesave për intervista, përgatitja e njoftimeve dhe organizimi i konferencave për media.

Rekomandimi 3

Të finalizojë dokumentet strategjike të Censit të Bujqësisë, të cilat do të shërbejnë për të planifikuar elementet më të rëndësishme të projektit, duke filluar me përgatitjen e kuadrit rregullator, vlerësimin e burimeve dhe aktorëve që do të përfshihen, buxhetin si dhe përcaktimin e metodologjisë që do të ndiqet për Censin e Bujqësisë 2024. Të paraqitet sa më parë në Kuvend për miratim projektligji për Censin e Bujqësisë.

Statusi: Në proces

INSTAT vijon punën për të zhvilluar në kohë dhe me sukses Cens-in e Ekonomive Bujqësore, i cili pritet të zhvillohet brenda vitit 2024. Në të njëjtën kohë po punohet me finalizimin e aspekteve metodologjike (nënshkrimi i MoU me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, draftimi i pyetësorit i cili është në fazë konsultimi me ekspertizën e FAO, dhe finalizimi i dokumentave strategjike të këtij aktiviteti). Ligji i Cens-it të Ekonomive Bujqësore është draftuar, i cili është duke u konsultuar me ekspert të Eurostat për të siguruar përfrimin me rregulloren EC 1091/2018 mbi Statistikat e Integruara të Fermave.

INSTAT punoi që brenda muajt Dhjetor 2023, të dërgojë draft-ligjin pranë zyrës së Kryeministrit dhe pritet miratimi në Parlament brenda 3-mujorit të parë, 2024.

Rekomandimi 4

Të vazhdojë modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave dhe prodhimit statistikor të Sistemit Kombëtar Statistikor, si mekanizimi kryesor për prodhimin e statistikave në përputhje me standardet e kërkuara nga Eurostat dhe në përputhje me teknikat me moderne ndërkombëtare.

Statusi: Në proces

Për realizimin e këtij rekomandimi, gjatë vitit 2023 INSTAT në kuadër të procesit të modernizimit të mbledhjes së të dhënave, ka punuar për ndërtimin e aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave me tablet/laptop (CAPI) apo përmes internetit(CAËI). Konkretisht janë mbledhur me metodën CAPI 10 anketa të ndryshme, ndërsa me metodën CAËI 6 prej tyre. Gjithashtu me metodën CAPI janë mbledhur edhe të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave, si aktiviteti më i rëndësishëm statistikor. INSTAT ka ndërtuar edhe dashboardin për monitorimin e punës në terren dhe zgjidhjen e problematikave. Përdorimi i metodave alternative për mbledhjen e të dhënave rrit cilësinë dhe efikasitetin, pasi këto aplikacione kanë të integruara kontrolle logjike.

Rekomandimi 5

Të vijojë përpjekjet për zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor me shtimin e institucioneve prodhuese dhe furnizuese me të dhëna, rritjen e gamës së produkteve statistike zyrtare të prodhuara dhe rritjen e cilësisë statistike.'

Statusi: Në proces

Zgjerimi i Sistemit Kombëtar Statistikor është objektiv i parashikuar në Strategjinë e Sistemit Kombëtar Statistikor, përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 si edhe rekomandimi i Rezolutës së Kuvendit për vitin 2023. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2023, u zhvilluan takime dypalëshe midis INSTAT dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), ku u diskutua gatishmëria e AKBN-së për tu bërë pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, detyrimet që lindin me marrjen e statusit agjenci statistike'. AKBN, në vijim konfirmoi dakortësinë për t'u bërë agjenci statistike dhe respektuar të drejtat e detyrimit. Pjesë e Planit Vjetor 2024 është prodhimi i statistikave të Energjisë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore duke u mbështetur nga INSTAT, në cilësinë e koordinatorit të Sistemit Kombëtar Statistikor. AKBN do të prodhojë dhe publikojë statistikën në volum të Bilancit të Përgjithshëm të Energjisë me frekuencë vjetore, si dhe Statistikat e Bilancit të Energjisë Elektrike, Qymyrit, Naftës dhe Gazit, me frekuencë tremujore.

Rekomandimi 6

Të bëjë përpjekje për uljen e qarkullimit të punonjësve dhe të sigurojë që niveli i plotësimit me punonjës është i mjaftueshëm për përmbushjen e nevojave të prodhimit statistikor. Gjithashtu, punonjësit të jenë të mirëtrajnuar lidhur me zhvillimet e fundit në fushën e statistikave.

Statusi: Në proces

Për përmbushjen e këtij rekomandimi, INSTAT ka punuar intensivisht për plotësimin e vendeve vakante në organikën e saj. Gjatë vitit 2023 janë përfunduar procedurat e konkurimit për 32 punonjës, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele dhe listës së pritjes. Aktualisht janë në proces konkurimi dhe rekrutimi për 9 pozicione. Gjatë këtij viti janë larguar 22 punonjës, nga të cilët 5 punonjës mbushën moshën për pensionin e pleqërisë. Aktualisht janë 9 pozicione vakante.

INSTAT dhe me mbështetjen e projekteve organizon një seri trajnimesh me synim zhvillimin e kapaciteteve në drejtim të përmirësimit të cilësisë së statistikave në nivel vendor, për punonjësit e INSTAT dhe të institucioneve të tjera. Gjatë vitit 2023 janë organizuar :

- 3 trajnime INSTAT ku janë trajnuar 65 persona

- 5 trajnime me mbështetjen e projektit SALSTAT 5 ku janë trajnuar 412 persona

60 trajnime dhe 9 trajnime afatgjatë, në kuader të programit IPA 2019 – ku janë trajnuar 69 persona. Gjatë fazës përgatitore të CENS 23 janë realizuar 7 trajnime për stafin e INSTAT dhe punonjësit e terrenit në të cilët janë trajnuar 6884 persona. Në përfundim të CENS 2023 është zhvilluar Anketa Pas Cens për të cilën janë trajnuar 130 persona.

Rekomandimi 7

Të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave makroekonomike në kohë dhe me cilësi të lartë në Eurostat për të arritur përputhje të plotë me standardet e ESA 2010 dhe të punojë për shtimin e treguesve të rëndësishëm, të cilët ende nuk i transmetohen Eurostatit.

Statusi: Në vazhdimësi

Në përmbushje të rekomandimit, gjatë vitit 2023 u finalizuan të gjithë aktivitetet statistikore në kuadër të programit IPA 2019 në fushën e statistikave makroekonomike duke përfshirë përmirësime metodologjike, shtim treguesish statistikorë dhe rritje të plotshmërisë së tabelave në përputhje me kërkesat e programit të transmetimit ESA 2010. U përpilua dhe transmetua si eksperimentale vlerësimet e setit të plotë të Llogarive të Sektorëve Institucional, 2013-2021; përpilimi dhe transmetimi i kuadrit të tretë pjesë e Tabelave Burim, Përdorime, 2017-2020 duke mundësuar vlerësimin eksperimental të PBB-së me metodën e të ardhurave; vlerësimi eksperimental i treguesve të Formimit Bruto të Kapitalit Fiks, Kompesimit të punonjësve dhe të ardhurave të familjeve në llogaritë rajonale si dhe përpilimi dhe transmetimi i PBB-së rajonale në T+12 në përputhje me programin e transmetimit; përmirësime në vlerësimin e treguesve vjetore Tabela e punësimit, import-eksporteve në terma tremujorë dhe vjetore; përmirësime në vlerësimin e ekonomisë së pavrojtuar; përmirësime në konsolidimin dhe rritjen e konsistencës në tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP) dhe statistikave financiare të qeverisë (GFS).

Gjithashtu INSTAT është duke punuar në zbatimin e të gjithë përmirësimeve të arritura në Revizionim Madhor të Llogarive Kombëtare 2024 i cili do të sjellë përmirësime në cilësinë e treguesve, rritje të tabelave të transmetuara sipas standardeve dhe kërkesave të BE-së në fushën e statistikave makroekonomike. Në kuadër të përafrimit me Acquis Communautaire, INSTAT miratoi dy udhëzime me fokus Aneksin A, ESA 2010 duke rritur nivelin e përputhshmërisë me ESA 2010.

Rekomandimi 8

Të intensifikojë bashkëpunimin statistikor kombëtar dhe ndërkombëtar për të përshtatur metodologjitë dhe praktikën më të mirë në rritjen e rolit të tij në qeverisjen e të dhënave publike si pjesë e ekosistemit të të dhënave, që shërbejnë për prodhimin e statistikave zyrtare, pa cënuar besimin në statistika dhe konfidencialitetin.

Statusi: Në proces

Në kuadër të këtij rekomandimi, INSTAT gjatë vitit 2023 ka punuar me 61 Bashkitë e Shqipërisë për të rritur kapacitetet e tyre statistikore dhe ndërgjegjësimin për rolin e statistikave zyrtare në Shqipëri. Me specifikisht rritjen e kapaciteteve të Bashkive si ofrues dhe përdorues të të dhënave me fokus përdorimin e të dhënave dhe analizën e tyre për Bashkitë. Gjatë vitit 2023 u realizuan 3 trajnime: si në fushën e statistikave të mbetjeve në të cilën u shpjeguan mjetet e mbledhjes së të dhënave të bazuara në ëeb,

përmbajtjen e tij dhe metodat që do të aplikohen për bashkitë; rëndësinë e statistikave vitale dhe regjistrave administrative; përdorimi programit Microsoft excel.

Zbatimi i Rekomandimeve të Peer Review 2018

Raporti i *Peer Review* 2018 parashikon 24 rekomandime, të operacionalizuara në 53 aktiviteteve zbatuese-përmirësuese.

Gjatë vitit 2023 ka vijuar puna në funksion të jetësimit të 3 aksioneve madhore si: Forcimi i Mjedisit Institucional; Zhvillimi i mëtejshëm i menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet; Përmirësimi i komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë, dhe situata aktuale e zbatimit të rekomandimeve dhe aktiviteteve përmirësuese që derivojnë nga këto 3 shtylla kryesore është si vijon:

Deri në fund të vitit 2023 rezulton të jenë realizuar të gjithë rekomandimet dhe aktivitetet zbatuese përkatëse.

Në vijim paraqiten rekomandimet e *Peer Review* 2018:

➤ Forcimi i mjedisit institucional

Rekomandimi nr. 1. INSTAT-i duhet të vlerësojë statistikave të prodhuara nga ministritë dhe agjencitë e tjera dhe duke marrë parasysh mendimin e Këshillit të Statistikave, të krijojë një listë më të gjerë të statistikave zyrtare. Kjo listë duhet të përfshijë të gjitha statistikave evropiane. Programi pesëvjeçar duhet të përshtatet në përputhje me këto rrethana.

Rekomandimi nr. 2. INSTAT duhet të krijojë një komitet të prodhuesve të statistikave zyrtare. Komiteti duhet të kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, dhe anëtarët duhet të jenë përfaqësuesit më të lartë statistikorë nga prodhuesit e tjerë.

Rekomandimi nr. 3. INSTAT duhet të krijojë dhe të mbajë një portal të përbashkët shpërndarje për të gjitha statistikave zyrtare.

Rekomandimi nr. 4. INSTAT-i duhet të publikojë një kalendar të përbashkët publikimi, që mbulon të gjitha statistikave zyrtare, duke treguar datën dhe kohën e publikimit dhe duhet të monitorojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e prodhuesve me këtë kalendar.

Rekomandimi nr. 5. INSTAT-i duhet të koordinojë dhe publikojë një raport vjetor të detajuar që përshkruan progresin në zbatimin e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare.

Rekomandimi nr. 6. INSTAT duhet të ushtrojë të drejtën e vet për të reaguar publikisht ndaj keqpërdorimit ose keqinterpretimit të statistikave zyrtare, për shembull duke lëshuar një deklaratë në faqen e saj në një numër të vogël rastesh të përzgjedhura mirë.

Rekomandimi nr. 7. INSTAT duhet të krijojë një Komision të Brendshëm të Konfidencialitetit; ofrojë udhëzime praktike për stafin se si të mbrohet më mirë konfidencialiteti në përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave; dhe të publikojë një Politikë të Konfidencialitetit në faqen e tij të internetit duke i shpjeguar, në terma të thjeshtë, palëve të interesuara (të anketuarve, ofruesve të të dhënave administrative, kërkuesve që hyjnë në mikrodeta) se si ata sigurohen që konfidencialiteti është i mbrojtur siç duhet.

Rekomandimi nr. 8. INSTAT duhet të ndërmarrë një vlerësim të çdo kërcënimi që mund të ndeshet në legjislacionin statistikor me akte të tjera legjislative, duke përfshirë Ligjin mbi Arkivat dhe Ligjin për të

Drejtën e Informimit. Nëse konfidencialiteti statistikor tregohet i rrezikuar, INSTAT duhet të propozojë ndryshime legislative pranë Qeverisë së Shqipërisë për të siguruar që konfidencialiteti statistikor të mbrohet siç duhet.

Rekomandimi nr. 9. INSTAT duhet të zhvillojë më tej kuadrin e tij të menaxhimit të cilësisë duke krijuar një komitet drejtues për cilësinë. Menaxhimi i cilësisë duhet të përqëndrohet në projektet që nevojiten për të mbështetur aktivitetet në të gjitha fushat statistikore, siç është zhvillimi i udhëzimeve të detajuara të cilësisë dhe publikimi i një deklarate cilësie.

➤ ***Zhvillimi i mëtejshëm i menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet***

Rekomandimi nr. 10. INSTAT-i duhet të rrisë përdorimin e teknikave elektronike të mbledhjes së të dhënave dhe të zvogëlojë burimet e dedikuara për intervistimin në anketat e njësive ekonomive familjare dhe bizneseve.

Rekomandimi nr. 11. Për të rritur efikasitetin e kostos, INSTAT duhet të synojë të përdorë shërbimin postar sa më shumë që të jetë e mundur për të shpërndarë pyetësorë dhe kujtesa në anketat e biznesit, ku vazhdojnë të përdoren pyetësorët letër

Rekomandimi nr. 12. INSTAT-i duhet t'i propozojë kompanive përkatëse që softëar-i për mbajtjen e rekordeve të ndërmarrjes të marrë në konsideratë nevojat e statistikave zyrtare.

Rekomandimi nr. 13. Njësia e metodologjisë në INSTAT duhet të ofrojë udhëzime metodologjike që janë të përshtatshme për të gjitha produktet statistikore, duhet të sigurojnë që këto udhëzime të ndiqen dhe duhet të përditësojë udhëzimet periodikisht.

Rekomandimi nr. 14. Për të ulur kostot, duke përfshirë kostot e trajnimit dhe mbështetjes, INSTAT duhet të racionalizojë gamën e mjeteve të Teknologjisë së Informacionit që përdoren në përpunimin statistikor.

Rekomandimi nr. 15. INSTAT-i duhet të planifikojë hapat e zbatimit për harmonizimin e proceseve të statistikore në drejtim të harmonizimit të hapave të planifikimit të prodhimit statistikor (GSBPM), në bashkëpunim me Institutet Kombëtare Statistikore të tjera aty ku është e mundur.

Rekomandimi nr. 16. INSTAT duhet të hartojë udhëzime për rishikime metodologjike, përfshirë vetëvlerësimin dhe auditimin statistikor. Duhet të hartohet një plan për të aplikuar rishikime në planet e përgjithshme të masave të INSTAT gjatë viteve të ardhshme.

Rekomandimi nr. 17. INSTAT-i duhet të caktojë një afat kohor për secilin produkt statistikor dhe duhet të monitorojë dhe raportojë për progresin.

Rekomandimi nr. 18. INSTAT-i dhe autoritetet e tjera kombëtare që prodhojnë statistika evropiane duhet të matin ngarkesën e përgjigjeve në mënyrë sistematike për të gjitha anketat. Menaxherët e lartë duhet të monitorojnë barrën dhe të caktojnë objektivat për reduktimin e saj me kalimin e kohës.

Rekomandimi nr. 19. INSTAT-i duhet të krijojë një sistem gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe produkteve statistikore dhe duhet të përdorë informacionin që rezulton për qëllime menaxhimi duke përfshirë edhe krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit.

➤ ***Përmirësimi i komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë***

Rekomandimi nr. 20. Këshilli i Statistikave duhet të jetë më vizibël në publik. Agjenda, procesverbali dhe kur është e mundur, çdo dokumentacion tjetër i mbledhjeve të Këshillit të Statistikave duhet të publikohen në një faqe të dedikuar në faqen e internetit të INSTAT-it.

Rekomandimi nr. 21. INSTAT duhet të krijojë një sistem të grupeve të përhershme të përdoruesve për fushat kyçe statistikore.

Rekomandimi nr. 22. Me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi në statistikat zyrtare, INSTAT duhet të punojë më aktivisht me gazetarët dhe mediat informative, duke ofruar seminare të mëtejshme, ëorkshope ose evente informale. Një faqe e dedikuar e internetit të INSTAT-it duhet t'i sigurojë medias informacion të përshtatshëm për qëllimet e tyre.

Rekomandimi nr. 23. INSTAT-i duhet të pasqyrojë një titull dhe një koment të përmirësuar në publikimet statistikore.

Rekomandimi nr. 24. INSTAT-i duhet të vazhdojë të forcojë bashkëpunimin me botën akademike duke zhvilluar metodologji, duke bashkëpunuar në prodhimin e statistikave zyrtare, duke trajnuar dhe duke përdorur mikro-të dhëna për analiza më të thella. Ajo duhet të ngarkojë një njësi të veçantë për koordinimin e aktiviteteve të bashkëpunimit me akademinë. Programet pesëvjeçare dhe ato vjetore duhet të ofrojnë informacion të hollësishëm për aktivitetet e planifikuara të bashkëpunimit dhe raportet vjetore duhet të japin detaje rreth rezultateve. Një faqe e dedikuar e internetit të INSTAT duhet të lehtësojë komunikimin me botën akademike dhe hulumtuesit.

XII. Burimet financiare dhe njerëzore

Burimet Financiare

INSTAT është institucion publik qëndror, i pavarur. Burimet e financimit për kryerjen e aktiviteteve statistikore dhe aktiviteteve mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Për vitin 2023 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit rreth 1,544 milion lekë, së bashku me donatorët janë shpenzuar 1,866 milion lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 11: Shpenzimet 2019-2023 (mijë/lekë)

FAKT					
SHPENZIMET	2019	2020	2021	2022	2023
Paga + kontribut	466,708.8	423,141.9	455,529.6	457,882.0	610,194.8
Mallra dhe shërbime të tjera	79,440.6	47,887.6	37,091.5	59,826.7	599,390.2
Totali operative	546,149.4	471,029.6	492,621.1	517,708.7	1,209,585.0
Investime	28,994.4	44,766.8	15,135.3	11,718.5	296,350.1
TOTALI BUXHETI	575,143.8	515,796.4	507,756.4	529,427.2	1,505,935.1

Paga + kontribut	19,134.7	32,445.1	35,269.1	32,045.6	37,649.0
Mallra dhe shërbime të tjera	1,993.4	25.7	11.3	52.8	55.0
Totali operative	21,128.1	32,470.8	35,280.4	32,098.3	37,704.0
Investime	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI nga të ardhurat	21,128.1	32,470.8	35,280.4	32,098.3	37,704.0
Paga + kontribut	962.3	9,425.7	3,174.3	1,477.6	1,822.6
Mallra dhe shërbime të tjera	25,219.2	18,406.8	86,566.2	7,634.1	3,996.5
Totali operative	26,181.5	27,832.4	89,740.6	9,111.8	5,819.2
Investime	1,920.0	21,347.5	0.0	0.0	0.0
Të ardhura jashtë limiti	28,101.5	49,180.0	89,740.6	9,111.8	5,819.2
Paga + kontribut	23,262.0	7,071.4	7,093.7	0.0	0.0
Mallra dhe shërbime të tjera	96,209.0	14,456.3	97,607.7	170,143.4	317,001.6
Totali operative	119,471.0	21,527.7	104,701.4	170,143.4	317,001.6
Investime	45,049.0	8,095.0	6,451.6	0.0	0.0
Të ardhura donator	164,520.0	29,622.7	111,153.0	170,143.4	317,001.6
Paga + kontribut	510,067.9	472,084.1	501,066.7	491,405.3	649,666.5
Mallra dhe shërbime të tjera	202,862.2	80,776.4	221,276.8	237,657.0	920,443.3
Totali operative	712,930.0	552,860.5	722,343.5	729,062.2	1,570,109.8
Investime	75,963.4	74,209.3	21,586.9	11,718.5	296,350.1
TOTALI	788,893.4	627,069.8	743,930.4	740,780.7	1,866,459.8


Tabela 12: Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 me fondet e buxhetit të shtetit

		VITI 2023 (mijë/lekë)			
Art	SHPENZIMET	PL Vjetor	PL i Rishikuar	Fakti	Real ne %
600	Paga	408,229.0	560,289.0	557,763.7	99.5
601	Kontribute sig shoq-shënd	69,171.0	92,719.6	90,080.2	97.2
602	Mallra dhe shërbime të tjera	496,426.0	629,595.0	597,912.1	95.0
604	Transferime korente	1,574.0	674.0	418.8	62.1
606	Transferime buxhetesh familjare	0.0	1,274.0	1,114.3	87.5
	SHUMA	975,400.0	1,284,551.6	1,247,289.0	97.1
231	Investime buxheti	355,600.0	296,500.0	296,350.1	99.9
	TOTALI	1331,000.0	1,581,051.6	1,543,639.1	97.6

Tabela 13: Realizimi i shpenzimeve me fondet e buxhetit të shtetit për vitet 2019-2023 jepet si më poshtë:
(mijë/lekë)

	2019	2020	2021	2022	2023 12-mujor
Paga + kontribut	485,844	455,587	490,799	489,928	647,844
Mallra dhe shërbime të tjera	81,434	47,913	37,103	59,880	599,445
Investime	28,994	44,767	15,135	11,719	296,350
Totali buxhetit	596,272	548,267	543,037	561,526	1,543,639

Figura 12 Realizimi i shpenzimeve me fondet e buxhetit të shtetit për vitet 2019-2023



Siç shihet nga grafiku volumin kryesor të shpenzimeve ndër vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe paga e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme. Për vitin 2023 zëri “Mallra dhe shërbime të tjera” zë një pjesë të madhe në shpenzimet si rezultat i kontraktimit të anketuesve me kontratë shërbimi në kuader të CENS 2023.

Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2023 i janë akorduar nga buxheti i shtetit 1,581 milion lekë nga 562 milion lekë të akorduara në vitin 2022, ose 1,019 milion lekë më shumë. Për periudhën Janar - Dhjetor 2023 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 1,544 milion lekë.

Realizimi i shpenzimeve të Aparatit Qëndror INSTAT dhe Zyrave të Statistikave në rrethe, sipas zërave.

Tabela 14: Realizimi i shpenzimeve Janar - Dhjetor 2023 mijë/lekë

APARATI DHE ZYRAT RAJONALE				mije /leke
Art.	SHPENZIMET	PL Vjetor	PL i Rishikuar	Fakti 12-mujor Real ne %
600	Paga	408,229.0	560,289.0	557,763.7 99.5
	Zyrat Rajonale	35,852.0	42,704.9	42,189.3 98.8

	Aparati Qëndror nga buxheti	340,113.0	485,320.1	483,310.3	99.6
	Aparati Qëndror nga të ardhurat	32,264.0	32,264.0	32,264.0	100.0
601	Kontribute sig shoq-shënd	69,171.0	92,719.6	90,080.2	97.2
	Zyrat Rajonale	5,994.0	7,133.6	7,039.7	98.7
	Aparati Qëndror nga buxheti	57,792.0	80,201.0	77,655.5	96.8
	Aparati Qëndror nga të ardhurat	5,385.0	5,385.0	5,385.0	100.0
602	Mallra dhe shërbime të tjera	496,426.0	629,595.0	597,912.1	95.0
	Zyrat Rajonale	6,623.0	6,776.0	5,929.6	87.5
	Aparati Qëndror nga buxheti	487,803.0	620,819.0	591,927.5	95.3
	Aparati Qëndror nga të ardhurat	2,000.0	2,000.0	55.0	2.8
604	Transferime korente	1,574.0	674.0	418.8	62.1
	Aparati Qëndror nga buxheti	1,574.0	674.0	418.8	62.1
606	Transferime buxhetesh familjare	0.0	1,274.0	1,114.3	87.5
	Zyrat Rajonale	0.0	0.0	0.0	0.0
	Aparati Qëndror nga buxheti	0.0	1,274.0	1,114.3	87.5
	SHUMA	975,400.0	1,284,551.6	1,247,289.0	97.1
	Investime Aparati Qëndror	355,600.0	296,500.0	296,350.1	99.9
230	Investime	0.0	0.0	0.0	0.0
231	Investime buxheti	355,600.0	296,500.0	296,350.1	99.9
	TOTALI BUXHETI	1,331,000.0	1,581,051.6	1,543,639.1	97.6

Sig shihet nga pasqyra, në artikullin 600, *Paga*, janë shpenzuar 557,764 mijë lekë e barabartë kjo me 99,5% të vlerës së parashikuar në Planin Vjetor.

- Në artikullin *Sigurime shoqërore e shëndetësore* janë shpenzuar 90,080 mijë lekë, e barabartë kjo me 97.2% të vlerës së parashikuar në Planin Vjetor.
- Në zërin *Mallra dhe shërbime të tjera*, për vitin 2023, janë shpenzuar 597,912 mijë lekë, e barabartë kjo me 95% të vlerës së parashikuar në Planin Vjetor.
- Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2023 për zërin *Transferta korrente të brendshme* është 674 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 419 mijë lekë, ose 62.1% e fondit.
- Gjatë vitit 2023 për zërin *Transferta për buxhete familjare* janë shpenzuar 1,114 mijë lekë ose 87.5%.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm është 296,350 mijë lekë ose 99.9% e totalit. Realizimi i shpenzimeve me Financim të Huaj për vitin 2023 është 317,001 mijë lekë. Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për vitin 2023 janë 5,819 mijë lekë.

Fondet INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistike”.

Tabela 15: Buxheti sipas programit “Veprimtaria Statistike”


Mijë /lekë

SHPENZIMET	Plani	Fakti	% Realizimi
Veprimtaria Statistike	1,581,052	1,543,639	97.6 %
Të ardhura jashtë limitit	0.0	5,819	0 %

TOTALI	1,581,052	1,549,458	98 %
---------------	------------------	------------------	-------------

Për programin e *Veprimtarisë Statistike* për vitin 2023 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 1,543,639 mijë lekë, ose 97,6% e vlerës së parashikuar në Planin Vjetor, nga të *Ardhurat jashtë limitit* janë shpenzuar 5,819 mijë lekë, në total janë shpenzuar 1,549,458 mijë lekë.

Figura 13: Buxheti 2023



Siç shihet nga të dhënat e tabelës dhe figurës së mësipërme, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600+601 (paga dhe sigurime), që zë rreth 35% të tij, në artikullin 602 *mallra dhe shërbime të tjera* që zë 34% të buxhetit dhe përartikullin 231 *shpenzime për investime* që zë 31%.

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, identifikimin dhe trajnimin e tyre, duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe rritjes së vazhdueshme të performancës.

Në këtë kuadër, INSTAT ka ndërmarrë disa hapa dhe është në proces të vazhdueshëm të hartimit të politikave dhe strategjive që ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Në funksion të matjes së kënaqësisë së punonjësve, INSTAT kryen anketën e kënaqësisë së punonjësve, si një strategji të vazhdueshme mbi analizën e faktorëve që ndikojnë në uljen apo rritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe hartimin e planit të veprimit mbi rritjen e kënaqësisë së punonjësve.


Gjatë vitit 2023, në zbatim të Strategjisë së Trajnimeve të INSTAT, Planit Vjetor dhe Kalendarit Vjetor të Trajnimeve, janë realizuar trajnime të vazhdueshme si brenda, ashtu edhe jashtë vendit me qëllim ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale.

Gjithashtu INSTAT gjatë vitit 2023, ka vijuar zhvillimin e procedurave të rekrutimit për shërbimin civil, në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar nëpërmjet sistemit online të rekrutimeve në faqen: [ëëë.rekrutime.instat.gov.al](http://eëë.rekrutime.instat.gov.al), proces i filluar në muajin Mars 2023.

Në organikën e INSTAT, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 127/2018 datë 29.12.2018, numri i punonjësve të miratuar është 236 punonjës (187 punonjës në qendër dhe 49 punonjës në zyrat rajonale).

Përsa i përket raportit gjinor të punonjësve të INSTAT, ashtu si dhe në vitet e mëparshme, në përbërjen e stafit të INSTAT kryeson gjinia femërore. Përqindja që zënë femrat në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve është 71% kundrejt meshkujve që zënë 29% të totalit.

Figura 14: Numri i punonjësve në raportin femra/meshkuj:



Rekrutime

Rekrutimi i nëpunësve të INSTAT-it kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Rekrutimi i nëpunësve kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse të INSTAT.

Njësia Përgjegjëse në INSTAT, gjatë vitit 2023 ka shpallur procedurat e rekrutimeve për 44 pozicione vakante, të publikuara në faqen e INSTAT dhe në faqen e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

1. Rekrutimet për kategorinë ekzekutive të shërbim civil (Specialistë)

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimeve për 27 punonjës, nga të cilët:

- 4 punonjës janë rekrutuar me procedurë të lëvizjes paralele;
- 19 punonjës janë rekrutuar me procedurën e pranimit në shërbim civil (5 punonjës janë pranë Zyrës Rajonale);

- 4 pozicione janë plotësuar nga lista e pritjes, ndërkohë që ka dhe 4 fitues në listë pritjeje
2. Rekrutime për kategorinë e nivelit të ulët drejtues (Përgjegjës Sektori).

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimit për 7 punonjës, nga të cilët:

- Të 7 punonjësit janë rekrutuar me procedurën e ngritjes në detyrë
3. Rekrutime për nëpunës civil të nivelit të mesëm drejtues (Drejtor Drejtorie).

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimit për 2 punonjës, nga të cilët:

- 1 punonjës është rekrutuar me procedurë të ngritjes në detyrë
 - 1 punonjës është rekrutuar me procedurë të lëvizjes paralele
- 8 vende vakante janë mbyllur pa fitues.

Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër

Gjatë vitit 2023 janë kontraktuar 447 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet si: kontrollor, kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qenë 830, të punësuar në pozicionet si: anketues me kontratë të përkohshme në pozicionet sipas anketave, anketues, operatorë dhe kontrollorë ankete.

Trajnimet e stafit

-Gjatë vitit 2023, në zbatim të Programit shumëpërfitues të bashkëpunimit IPA 2019 janë zhvilluar 10 trajnime afatgjatë, ku janë trajnuar 9 punonjës të INSTAT dhe 1 punonjës i Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu janë zhvilluar 56 trajnime afatshkurtra me 59 të trajnuar.

-Instituti i Statistikave, në zbatim të ligjit 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, si dhe të planit vjetor të trajnimeve, ka zhvilluar 3 trajnime për punonjësit e INSTAT, ku janë trajnuar 65 punonjës.


-Me mbështetjen e Projektit SALSTAT (Strong Albanian Local Statistics) financuar nga Sëiss Development Cooperation Office (SDC) janë kryer 5 trajnime dhe kanë marrë pjesë 421 punonjës nga INSTAT dhe bashkitë.

-Gjatë vitit 2023, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka kryer një sërë trajnimesh me tema, të cilat përfshijnë kategori të ndryshme njohurish dedikuar nivelit ekzekutiv apo drejtues. I janë nështruar trajnimit të detyrueshëm për marrjen e statusit të nëpunësit civil 31 punonjës të INSTAT.

-Në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave janë zhvilluar 2 trajnime me 150 punonjës të trajnuar (KCBN) dhe 9 trajnime me 6868 punonjës terreni të trajnuar.

- Aneksi Nr.1 Të dhënat kryesore
- Aneksi Nr. 2 Aktivitetet statistikore të realizuara gjatë vitit 2023
- Aneksi Nr.3 Fushata e komunikimit në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023
- Aneksi Nr. 4 Memorandumet e Mirëkuptimit
- Aneksi Nr. 5 Lista e Nomenklaturave në fuqi

Aneksi nr. 1. Të dhënat kryesore



**Bazuar në vlerësimet tremujore*

Aneksi Nr.3 Fushata e komunikimit në kuadër të Censit të Popullsisë dhe banesave 2023

Gjatë vitit 2023 komunikimi ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në mbështetje të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023, duke ndjekur dhe zbatuar fushatën e komunikimit për rekrutimin e stafit të terrenit si dhe fushatën e komunikimit për publikun e gjerë, duke rritur vizibilitetin për Cens-in dhe për INSTAT.


Në muajin maj 2023, njësia e komunikimi dhe publikimit mbështetën procesin e Censit të Popullsisë dhe Banesave duke filluar me fushatën e komunikimit për rekrutimin e punonjësve të terrenit.

Gjatë periudhës 15 Maj 2023 – 24 Gusht 2023 në 61 Bashkitë e vendit u vendosën citylights dhe stenda informuese në lidhje me procesin e cens dhe rekrutimet, duke informuar publikun e gjerë për mënyrën se si

mund të aplikohej për tu bërë pjesë e stafit të Cens. Fushata e rekrutimeve ka qënë aktive në rrjetet sociale zyrtare të INSTAT si dhe në televizione dhe radio me spotet informuese.

Kolazh me foto gjatë fushatës së rekrutimit





Pas përfundimit të fushatës së rekrutimeve, njësia e komunikimit dhe publikimit filluan përgatitjet për fushatën masive të komunikimit dhe informimit për procesin e Censit.

Me datë 13 Shtator 2023, njësia e komunikimit dhe publikimeve dha ndihmesë në organizimin e Konferencës Hapëse të Cens.





Gjatë muajit Shtator – Tetor fushata e komunikimit ka qenë aktive dhe masive në rrjete sociale, në TV kombëtare dhe lokale, në radiot kombëtare dhe lokale nëpërmjet intervistave dhe konferencave për shtyp, nëpërmjet spoteve informuese për procesin, nëpërmjet turit të Cens nëpër qarqe e bashki ku u shpërndanë materiale informuese dhe promocionale, nëpërmjet billboard, city lights, led ëall dhe posterave të personalizuar për çdo bashki.

Kolazh me foto gjatë fushatës masive të komunikimit







Aneksi nr. 4 Memorandumet e Mirëkuptimit

Nr.	Memorandume Mirëkuptimi	Data e nëshkrimit	Shënime
<u>Prodhues të statistikave zyrtare</u>			
1	Banka e Shqipërisë	12.05.2008	
2	Ministria Financave dhe Banka e Shqipërisë	03.10.2016	
<u>Ofrues të të dhënave administrative / Përdorues</u>			
3	Ministria e Brendshme (MB)	11.11.2010	
4	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)	11.03.2015	
5	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)	11.04.2017	Përditësuar 31.10.2019
6	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)	18.04.2017	Përditësuar 28.10.2019
7	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)	08.05.2017	Përditësuar 22.01.2020
8	Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH)	06.06.2017	Përditësuar 12.04.2022
9	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	09.06.2017	Përditësuar 22.01.2020
10	Ministria e Mbrojtjes (MM)	13.06.2017	
11	Ministria e Kulturës (MK)	14.07.2017	
12	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)	05.09.2017	Përditësuar 24.02.2020
13	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)	27.09.2017	Përditësuar 11.12.2019
14	Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT)	06.10.2017	
15	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)	17.11.2017	Përditësuar 31.08.2020

16	Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)	14.12.2017	
17	Fondi Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)	20.12.2017	
18	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)	06.02.2018	
19	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)	09.02.2018	Përditësuar 22.08.2018
20	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (DHTI)	20.03.2018	Përditësuar 10.05.2022
21	Instituti Shëndetit Publik (ISHP)	19.04.2018	Përditësuar 30.10.2019
22	Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP)	19.11.2018	
23	Prokuroria e Përgjithshme (PP)	30.10.2019	
24	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)	09.07.2020	
25	Avokati i Popullit (AP)	03.09.2020	
26	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF)	30.03.2021	
27	Ministria e Drejtësisë (MD)	11.11.2021	
28	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC)	20.07.2022	
29	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD)	06.06.2005	Përditësuar 06.09.2011
30	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)	03.05.2023	
	<u>Memorandume Mirëkuptimi / Marrëveshje</u> <u>Bashkëpunimi ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të</u> <u>tjera:</u>		
31	Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)	07.06.2021	
32	Enti shtetëror i Statistikave të Maqedonisë së Veriut (MAKSTAT)	09.12.2022	
33	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	02.02.2022	
34	UNICEF- Zyra e UNICEF në Shqipëri	31.05.2022	
35	Fakulteti i Ekonomisë Universiteti i Tiranës (FEUT)	25.10.2022	
36	FGJH UT - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja Universiteti i Tiranës	12.09.2023	
37	KI - Këshilli Investimeve	12.09.2023	
38	UP - Universiteti Polis	28.09.2023	
39	SESRIC-Statistical Economic and Social Research and Training Center for Islamic Countries	10.05.2023	

Aneksi nr. 5 Lista e Nomenklaturave në fuqi

Nr	Emri i nomenklaturës	i Bazaligjore kombëtare	Baza evropiane/ndërkombëtare	ligjore	Përmbajtja e bazës ligjore
----	----------------------	-------------------------	------------------------------	---------	----------------------------

1	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev2	Vendim i KM nr. 320, datë 28.5.2014 "Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2)"	Rregullore e Komisionit (EC) Nr 1893/2006 e 20 Dhjetorit 2006 mbi Klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NACE Revision 2	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev2
2	Nomenklatura e Mallrave dhe Tarifave	1. Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. 2. VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	Rregullorja e Këshillit të Evropës, Nr 2658/87, të datës 23 korrik mbi nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (Rregullorja bazë)	http://www.dogana.gov.al/dokument/1179/ligj-nr-102-2014-date-3172014-i-ndryshuar http://www.dogana.gov.al/dokument/1497/dz-vkm-nr-651-date-10112017
3	Nomenklatura e produkteve	Vendim i KM Nr. 433 datë 17.6.1996 "Për miratimin ezbatimit të nomenklaturës së produkteve"	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr. 1232/98 datë 17 Qershor 1998, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr. 3696/93 mbi Klasifikimin statistikor të produkteve sipas Aktiviteteve (CPA).	http://www.instat.gov.al/media/1841/nomenklatura_e_produkteve_sipas_aktiviteteve.pdf
4	Nomenklatura e Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 20.9.2017 për "Miratimin e zbatimit të klasifikimit të produkteve të konsumit sipas qëllimit (COICOP)".	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr. 1749/1999, datë 23 Korrik 1999 "Mbi klasifikimin e konsumit individual sipas qëllimit".	http://www.instat.gov.al/media/3959/02_nomenklatura_coicop_5digit_i_plotë_final.al.pdf
5	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtar i Profesioneve (LKP) është një mjet për grupimin e vendeve të punës në grupe të përcaktuara	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), të rishikuar	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr 1022/2009, datë 29 Tetor 2009 "Mbi Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Profesioneve".	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtar i Profesioneve (LKP)

	qartë sipas detyrave të ndërmarra në punë.			
6	Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.136, datë 20.3.2019 "Për Miratimin e Nomenklaturës së Klasifikimit të Llojeve të Ndërtimit (KN)		Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit
7	Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit	Vendimi i KM Nr. 137, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës së Statistikave të Transportit".	Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1304/2007, datë 7 Nëntor 2007, amenduar me Direktivën e Këshillit Nr. 95/64, Rregulloren e Këshillit Nr. 1172/98, Rregulloret e KE Nr. 91/2003 dhe Nr. 1365/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me themelimin e NST 2007 si klasifikimin unik për mallrat e transportuara në mënyrat e caktuara të transportit.	Nomenklatura Standarde e Transporte
8	Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin	Vendimi i KM Nr. 135, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës Ndërkombëtare të Sëmundjeve ICD-10".		Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizioni i 10-të/vëllimil Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizionimi i 10-të/vëllimil
9	Klasifikimi i Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen	Vendimi i KM, Nr. 541, datë 29.09.2021 "Për miratimin e Nomenklaturës së Shteteve dhe të Territoreve për Statistikat e	Rregullore e Komisionit të Bashkimit Evropian 2020/1470, datë 12 Tetor 2020 mbi Nomenklaturën e Shteteve dhe Territoreve për Statistikat Evropiane	Klasifikimi i Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit. (GEONOM)

	Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit. (GEONOM)	Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit"	për Tregtinë Ndërkombëtare të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit.	
10	Nomenklatura e produkteve sipas aktiviteteve	Baza ligjore kombëtare: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 142, datë 11.3.2022 "Për miratimin e nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteteve (NPA 2.1)"	Baza ligjore evropiane: Rregullorja e Komisionit Evropian (BE) Nr. 1209/2014 e datës 29.10.2014 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 451/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për vendosjen e një klasifikimi të ri statistikor të produkteve sipas aktivitetit (CPA) dhe duke shfuqizuar Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3696/93	<u>Nomenklatura e produkteve sipas aktiviteteve</u>
11	Klasifikimi Standard i Arsimit, KSNA 2011 Fushat e arsimit dhe trajnimit, KSNA-F 2013	Baza ligjore kombëtare: Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 11.5.2022 "Për miratimin e Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011), të fushave të Arsimit dhe të Trajnimit të KSNA 2013 (KSNA-F 2013) dhe të përshkrimeve të tyre të detajuara".		<u>Klasifikimi Standard i Arsimit, KSNA 2011</u> <u>Fushat e arsimit dhe trainimit,</u> <u>KSNA-F 2013</u>